



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.09.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit të punimeve të Komisionit për Ekonominë dhe Financat për periudhën 3-21 shtator 2018.
2. Miratimi i procesverbalit.
3. Akti normativ nr. 1, datë 26.7.2018, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018””.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj dhe Xhevit Bushaj.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Reme Lala, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Gelardina Prodani – Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhëmbi – Drejtoreshë e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – Drejtor i Politikave Fiskale në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Endrit Lami – Drejtor i Makroekonomisë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Knidi Bashari – Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alba Çaroshi – Këshilltare në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Arbër Lleshi – Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit.

Në rendin e ditës së punës së këtij komisioni për sot kemi miratimin e kalendarit të punimeve të Komisionit për Ekonominë dhe Financat për periudhën 3-21 shtator 2018 dhe aktin normativ nr. 1, datë 26.7.2018, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018””.

Fillojmë me çështjen e parë. Të gjithë e keni përpara kalendarin e punimeve 3-javore të komisionit. Janë disa nisma që duhen shqyrtuar. Pas aktit normativ do të vijojmë me dekretin e Presidentit “Për kthimin për shqyrtim në Kuvend të ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë, 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat, të ndryshuar””. Më pas do të vazhdojmë me një ndryshim që është kërkuar me procedurë të përshpejtuar nga qeveria për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist dhe pastaj me radhë me çështjet e tjera.

Ka ndonjë vërejtje ose sugjerim për kalendarin?

(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon)

Dua t’ju bëj me dije edhe se kalendari u është dërguar edhe partive të opozitës, por me sa duket janë të zëna në një proces numërimi.

Meqenëse nuk ka vërejtje lidhur me kalendarin, e hedhim në votë.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës, shqyrtimin e aktit normativ nr. 1, datë 26.07.2018 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2018”.

Për të prezantuar aktin normativ ndodhet në Komisionin e Ekonomisë ministri i Financave dhe Ekonomisë, zoti Arben Ahmetaj. Relator i komisionit lidhur me projektligjin është zoti Anastas Angjeli.

Do të procedojmë me prezantimin e aktit normativ nga ana e zotit ministër, për të vijuar me relatorin e komisionit.

Zoti Ministër, fjala është për ju.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, të nderuar anëtarë të komisionit!

Unë do ta nis fjalën time me një parashtrim të situatës makroekonomike, për të kaluar pastaj në detaje të aktit normativ, duke iu referuar edhe statistikave, të dhënave qoftë në

mënyrë kuantitative, qoftë në mënyrë cilësore të fiskut deri në fund shtatëmuorit, si dhe në mënyrë operative deri në fund të tetëmuorit.

Viti 2018 ka vijuar të konsolidojë trendin përshpejtues të ekonomisë shqiptare, ka filluar tashmë që prej vitit 2014, pra është viti i pestë me një përshpejtim të rritjes ekonomike, një trend domethënës, që reflekton se kjo performancë është e bazuar më në fund jo në rastësi, por në fondamentet ekonomike.

Prodhimi i brendshëm bruto (PBB) u rrit me 4,45 % në terma realë në tremujorin e parë të vitit 2018 dhe të gjitha të dhënat indirekte tregojnë që të kemi po një rritje të këtij niveli edhe në tremujorin e dytë. Ndërkohë, objektivi ynë vazhdon të qëndrojë në rritje, 4% deri në 4.2%, në fund të vitit 2018, dhe në referencë të planifikimeve që institucionet ndërkombëtare me gjithë qëndrimin konservator në përgjithësi të tyre, referojnë për ekonominë shqiptare.

Komponentët e shpenzimeve, të cilët gjeneruan pjesën më të madhe të rritjes ekonomike në tremujorin e parë të vitit 2018, ishin konsumi dhe investimet, pra konsum i bazuar kryesisht te kërkesa e brendshme. Përkatësisht, konsumi total u rrit me rreth 2,96%, gati 3% në terma realë, po aq edhe ai i privat i familjeve, që tregon për disa tremujorë rresht rritje të konsoliduar të konsumit, siç e referuam, i bazuar në kërkesën e brendshme dhe në përmirësimin, pra në konsekuencë edhe për shkak të përmirësimit të konsiderueshëm të tregut të punës.

Investimet totale gjatë tremujorit të parë të vitit 2018 u rritën me rreth 5,43% në terma realë. Tek investimet vlen të përmendim ecurinë e investimeve të huaja direkte në tremujorin e parë, të cilat patën një rritje tejet të fortë me mbi 60%. Ky zhvillim përbën një tejkalim të konsiderueshëm të pritshmërive fillestare për tremujorin e parë të vitit 2018, sepse, në fakt, edhe sipas referencave të institucioneve ndërkombëtare, pritej një lloj ngadalësimi për shkak se projektet e mëdha kanë filluar të ulin ritmet e investimit dhe janë në dy vjetët e fundit të tyre. Megjithatë, surpriza jo e rastësishme është që investimet arritën nivel rekord këtë tremujor.

Nga të dhënat indirekte, edhe në diskutimet me shifra operative me Bankën e Shqipërisë, mendohet që investimet e huaja në tremujorin e dytë të arrijnë në nivelin 210-220 milionë euro. Kjo do të thotë që të arrijnë nivelin e 500 milionë eurove në gjashtë muaj. Sipas të gjitha gjasave kjo do të thotë që viti 2018 të shënojë një rekord të ri, historik, në investimet e huaja në vendin tonë.

Ndërkohë, është me interes të shikohen tremujori i dytë dhe ai i tretë për sa u takon eksporteve të shërbimeve pasi pritshmëritë dhe vlerësimet paraprake për sektorin e turizmit të

këtij viti janë shumë optimiste. Për rrjedhojë, presim që gjatë vitit kërkesa e brendshme të vijojë të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes ekonomike. Nëse i referohemi shifrave të turizmit, që përkufizohen brenda eksportit të shërbimeve, në shtatë muaj Shqipërinë e kanë vizituar 2,9 milionë shtetas të huaj. Vetëm në korrik e vizituan mbi 1 milion, kurse muaji gusht, nga të dhënat tona operative, ka njohur përsëri numër rekord të shtetasve të huaj që kanë vizituar për turizëm Shqipërinë. Kjo do të thotë që në tetë muaj kemi arritur shifrën rekord në historinë e këtij sektori, 4,2 - 4,4 milionë turistë. Kjo do të thotë që ky vit do të vendosë rekord për turizmin dhe investimet e huaja me mbi 5,8 milionë turistë deri në fund të vitit.

Sektorët që gjeneruan pjesën dërrmuese të rritjes ekonomike ishin industria, e cila u rrit në terma realë me pothuajse 20%, 19,9% për të qenë të saktë, tregtia, e cila u rrit me 3,75% dhe bujqësia që u rrit me 2%. Performanca e mirë e ekonomisë reale gjatë vitit 2017 dhe tremujorit të parë të vitit 2018 u reflektua qartësisht edhe në tregun e punës. Në fund të vitit 2017 shkalla e papunësisë ra në nivelin 13,6%, ndërsa vijoi të bjerë sërish në tremujorin e parë të vitit 2018 në 12,5% duke regjistruar nivelin më të ulët që nga tremujori i parë i vitit 2012. Ndërkohë, punësimi për popullsinë 15 vjeç e lart u zgjerua me 3,4% gjatë vitit 2017 ose 38 000 të punësuar të rinj. Gjithashtu, punësimi u zgjerua në tremujorin e parë të vitit 2018 me 3,5% krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2017. Kjo ishte një panoramë shumë e shkurtër e përmirësimit të tregut të punës, qoftë në uljen e papunësisë, qoftë në rritjen e pjesëmarrjes në forcën e punës.

Perceptimi i agjentëve ekonomikë mbi ekonominë ka njohur një përmirësim të dukshëm, siç dëshmohet në treguesin e ndjesisë ekonomike. Ky tregues sot qëndron mbi mesataren afatgjatë që prej tremujorit të dytë të vitit 2016. Pra, për ta thënë ndryshe, që prej tremujorit të dytë të vitit 2016 aktorët ekonomikë vetëm kanë rritur dhe konsoliduar ndjesinë e tyre ekonomike pozitive për ekonominë shqiptare.

Për sa i përket ecurisë fiskale, në aktin normativ të miratuar nga qeveria në korrik të vitit 2018, totali i të ardhurave të buxhetit nuk ka ndryshuar duke ruajtur të njëjtin nivel të parashikuar në fillim të vitit me 464,7 miliardë lekë. Po kështu, totali i të ardhurave tatimore nuk ka ndryshuar. Ato janë 424, 44 miliardë lekë, e njëjta shumë e miratuar në ligjin fillestar të buxhetit për vitin 2018.

Axhustimet e nevojshme dhe të domosdoshme janë bërë brenda zërave të të ardhurave me qëllim pasqyrimin e efekteve të faktorëve të paparashikuar, të cilët kanë ndikuar në gjashtëmujorin e parë. Janë axhustuar të ardhurat nga TVSH-ja për 3,5 miliardë lekë ulje, që lidhen me:

Reduktimin e TVSH-së në import nga rënia e kursit të këmbimit të monedhave të huaja euro dhe dollarë krahasuar me lekun. Efekti i matur i këtij faktori, që është përtej duarve dhe mundësive tona për t'u kontrolluar, në gjashtëmujor shkon 4 miliardë dhe në tetëmujor ka arritur shifrën 5 miliardë. Pra, dua t'i them komisionit, qytetarëve dhe kujt do që është i interesuar, që, për shkak të mbivlerësimit të lekut, në kuadrin kohor të 8 muajve buxheti ka pësuar një goditje vetëm në këtë korsi prej gati 5 miliardë lekësh. Të dhënë e gushtit e kemi akoma operative dhe sigurisht që do ta axhustojmë në mënyrë më të saktë kur të kemi shifrën finale nga dogana dhe thesari.

Përsheptimi i rimbursimit të TVSH-së për eksportuesit dhe investimet në projektet e mëdha të TAP-it me 1,3 miliardë lekë krahasuar me vitin e kaluar dhe 0,6 miliardë lekë krahasuar me planin e gjashtëmujorit të parë. Pra, po përsheptojmë procesin e rimbursimit të TAP-it.

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin korporativ u reduktuan me 0,5 miliardë lekë me qëllim reflektimin e situatës energjetike të vitit të kaluar me importe të konsiderueshme të energjisë elektrike, çka ndikoi në uljen e parametrave ekonomikë të ndërmarrjeve të sistemit energjetik, KESH dhe OSHEE, fitimit të tyre dhe rrjedhimisht edhe kontributeve fiskale të buxhetit të shtetit.

Sqaroj se situata jo e favorshme e vitit të kaluar është rikuperuar në vitin që po kalojmë, çka do të japë efekte pozitive në rezultatin financiar të tyre, pra, në fitimin e këtyre kompanive dhe do të reflektohet në kontributet fiskale për buxhetin e shtetit në vitin pasardhës.

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale u axhustuan +0,5 miliardë lekë me qëllim pasqyrimin dhe reflektimin tek interesat.

Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore u rritën me 4, 5 miliardë lekë, për të pasqyruar situatën pozitive të gjashtëmujorit të parë në mbledhjen e të ardhurave nga kontributet, rezultat ky i ndërgjegjësimit të punëmarrësve dhe punëdhënësve, si dhe i aksionit të ndërmarrë në kuadrin e antiinformalitetit.

Në muajin korrik të vitit 2018, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga vetë kompanitë, në Shqipëri rezultojnë 724 mijë vende pune të deklaruar me 690 mijë të punësuar të deklaruar. Pra, 724 mijë vende pune të deklaruar me 690 mijë të punësuar të deklaruar nga vetë kompanitë. Krahasoni 690 mijë të punësuar me 430 mijë të punësuar në vitin 2013. Pra, nga 690 mijë të punësuar që ka Republika e Shqipërisë dhe ekonomia shqiptare që nga viti 1 i demokracisë dhe deri sot që kanë kaluar gati 27 vjet, gati 250 mijë

janë punësuar vetëm në 4 vitet e fundit. Do të thotë se pak më shumë se 35% e të punësuarve janë punësuar në mandatin e parë të qeverisë “Rama”.

Sigurisht që diskutimi mund të vazhdojë, pritshmëritë e qytetarëve janë shumë të madha në legjitimitet dhe në të drejtë të tyre, jemi larg asaj që duam të arrijmë, por unë dua t’i kujtoj komisionit dhe të gjithë qytetarëve që mund të na ndjekin që të mos harrojmë që kemi ardhur nga një krizë e rëndë ekonomike financiare dhe fiskale e vitit 2013. Viti 2012 ishte viti kur, duke iu referuar edhe raportit të Bankës Botërore, varfëria arriti kulmin në Shqipëri, kur papunësia dhe mjerimi ekonomik ishin të pa krahasuar edhe me vitet ‘97-‘98. Ndërkohë, që prej vitit 2013 kemi bërë të mundur së bashku me të gjithë aktorët në ekonomi që ekonomia të krijojë gati 260 mijë vende pune, të cilat janë mbi 35% e të gjitha vendeve të krijuara në gati 30 vjet në Shqipëri.

Ndërkohë, për sa u përket zhvillimeve buxhetore, ndikuar prej ecurisë pozitive të treguesve kryesorë makroekonomikë, edhe treguesit kryesorë fiskalë dhe buxhetorë shfaqin të njëjtin trend. Të ardhurat e përgjithshme për muajin e shtatë të vitit 2018 arritën në rreth 255 miliardë lekë.

Këtu dua të ndaloj pak për të shuar atë debat që bëjmë përtej syve, veshëve dhe mendjes së qytetarëve. Në krahasim me vitin 2013 ne mbledhim sot 1 miliard dollarë më shumë në vit. Kjo deri në fund të vitit 2017, sepse këtë vit sigurisht që rezultati do të përmirësohet. A ka punë për të bërë? Plot ka.

Me gjithë goditjet që kemi pasur për shkak të kursit të këmbimit, sërish balanca fiskale dhe njëtrajtshmëria makroekonomike duke furnizuar rritjen është e garantuar.

Ndërkohë, realizimi shkon në masën 97% të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017 ky zë ka rezultuar 3% më i lartë ose 7,5 miliardë lekë më shumë, rreth 75 milionë dollarë më shumë sesa viti i kaluar.

Në terma vjetorë, në krahasim me periudhën, ato u realizuan në masën 55,1% të planit vjetor. Në të njëjtën kohë, shpenzimet e përgjithshme publike për muajin e shtatë të vitit 2018 arritën në rreth 252,8 miliardë lekë me një realizim të kënaqshëm prej 95,1%. Sipas të dhënave të mia operative, muaji gusht ka një përshpejtim të shpenzimeve dhe besoj që këto muaj, për shkak të profilit të ecurisë së investimeve publike apo të shpenzimeve në tërësi, do të shikojmë një përshpejtim të realizimit të shpenzimeve qoftë në total, qoftë në zëra specifikë.

Veçojmë shpenzimet korrente të realizuara me 218 miliardë lekë ose 1,7% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar; shpenzimet kapitale me një realizim në masën 34,7 miliardë lekë ose 19,1% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Për rrjedhojë, për 7 muajt e parë të vitit 2017 buxheti ka realizuar akoma një suficit të përgjithshëm prej 3,1 miliardë lekësh ose rreth 7,2% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë, kjo e shoqëruar me një suficit primar prej rreth 21,2 miliardë lekë ose 1,3% e prodhimit të brendshëm bruto në nivel 7-mujor, në linjë me objektivat indikative të vendosura në fund të programit me Fondin Monetar Ndërkombëtar për përdhën që do të pasonte programin, pra për periudhën korrente.

Akti normativ nr. 1 i buxhetit të vitit 2018.

Pavarësisht ecures tejet pozitive të ekonomisë dhe financave publike, Ministria e Financave dhe e Ekonomisë ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të buxhetit 2018.

Ky rishikim u propozua t'i nënshtrohet procedurës së aktit normativ për arsye kryesore që vijojnë: sigurimin e një shpërblimi për pensionistët dhe familjet në nevojë në fund të vitit; rritjen e eficiencës së përdorimeve të burimeve publike për rialokime drejt projekteve të investimeve me progres më të mirë deri tani; rritjen e sigurisë në realizimin e treguesve të buxhetit; sistemimin e të ardhurave midis zërave, me efekt zero; alokimin e burimeve drejt projekteve të investimeve publike, të cilat rezultojnë me progres më të mirë, siç e thashë, me qëllim arritjen e nivelit të programuar të tyre në vitin 2018; shlyerjen në kohë të detyrimeve financiare kontraktuale të institucioneve buxhetore nëpërmjet rialokimeve buxhetore të këtij akti normativ. Kështu reduktohet mundësia e krijimit të detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2018.

Mbi të gjitha, duhet theksuar se ndryshimet e propozuara nuk prekin treguesit kryesorë makroekonomikë dhe fiskalë, duke ruajtur deficitin në nivel të pandryshueshëm, duke garantuar dhe forcuar më tej objektivin e qeverisë për qëndrueshmëri fiskale.

Më konkretisht, akti normativ që ju propozojmë konstaton në ruajtjen e parametrave kryesorë të buxhetit të miratuar në fillim të vitit. Deficiti buxhetor, siç e theksova, mbetet i pandryshuar, ndërkohë që të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit pësojnë sistemime midis zërave, efekt neutral ky për buxhetin e shtetit; rialokime brenda zërave të buxhetit, kryesisht për miratimin e një fondi në masën 3 miliardë lekë për shpërblimin e pensionistëve (rreth 5 mijë lekë të rinj për çdo pensionist), që është rezultat i kursimeve nga skema e sigurimeve shoqërore shëndetësore, si dhe parashikimi i rritjes së të ardhurave nga kontributet në këto skema; miratimi i një bonusi rreth 300 milionë lekë për kategoritë në nevojë, pra që shkon gjithë paketa e solidaritetit 3,3 miliardë (pak më vonë do të sjell tabelën shumë të rëndësishme për ta ndarë me komisionin); rialokimi i shpenzimeve kapitale, ku kryefjala është rialokimi nga projektet me ecuri të ngadaltë.

Gjithashtu, kemi mbështetur sektorin energjetik përmes rritjes me 1,5 miliardë lekë të tavanit të financimit të huaj, tashmë të konsumuar, asaj që i referohemi si *landing*.

Së fundi, është mbështetur me 1 miliardë lekë financimi i plotë i projektit në vazhdim dhe hapja e disa projekteve të reja prioritare me financim të brendshëm.

Gjithashtu, kemi disa rialokime në mbështetje të familjeve që përfitojnë nga bonusi i strehimit nëpërmjet rialokimeve të brendshme me zëra dhe shpenzime buxhetore të programeve të strehimit, si dhe disa rialokime të tjera.

Në gjykimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe qeverisë shqiptare, ky akt normativ jep më shumë garanci për rritje ekonomike të qenësishme në favor të qytetarëve të këtij vendi nëpërmjet instrumenteve fiskale buxhetore me standardet e duhura.

Përpara se ta mbyll fjalën time, do të doja t'u tërhiqja vëmendjen deputetëve të një tabelë shumë interesante, e cila mbyll debatin se çfarë vëmendjeje ka kjo maxhorancë për qytetarët.

Kemi bërë debat se sa i kemi mbështetur pensionistët dhe familjet në nevojë me atë që ne i referohemi si “paketa e solidaritetit”. Po ta shikoni, kam bërë një krahasim midis qeverisjes 8-vjeçare të PD-së dhe asaj 4-vjeçare për PS-së. Totali i qeverisë së Partisë Demokratike në 8 vjet ka qenë 10,5 miliardë, dhe po ta shikoni profilin e dhënies së bonusit gjatë qeverisë së tyre, është një herë në dy vjet, gjatë viteve elektorale, ndërsa po të shikoni atë që kemi bërë në 4 vjet (te lutem, se dua të lexoj shifrën) është 11,3 miliardë. Pra, në 4 vjet ne kemi dhënë më shumë se ç'kanë dhënë ata, gati 10% më shumë se ç'kanë dhënë ata në 8 vjet dhe mënyra e ofrimit të paketës së solidaritetit nga ana jonë nuk ka lidhje fare me vitet elektorale. Shikojini kohën kur ne japim bonus pa dallim dhe kohën kur ata kanë tentuar të japin bonuse vetëm në vite elektorale.

Pra, kjo besoj se e mbyll, për qytetarët që duan të dëgjojnë, debatin se kush ka dhënë më shumë, kush ka pasur më shumë vëmendje dhe kush ka tentuar të manipulojë financat publike në funksion të interesave elektorale.

Paketa e solidaritetit është kthyer në një standard dhe kjo është edhe arsyeja pse qeveria e ka sjellë të konsoliduar në buxhet, me shifër konkrete për të garantuar të gjithë qytetarët që do të përfitojnë, pra pensionistët dhe familjet në nevojë, që në planet e saj qeveria ka vëmendje totale ndaj qytetarit. E gjithë vëmendja shkon te qytetarët.

Para se të mbaroj, do të doja të bëja një rezymë vetëm të një elementi, që lidh atë çka kemi bërë më shëndetësinë, për shembull, për të treguar edhe këtu vëmendjen ndaj qytetarëve.

Nëpërmjet qasjes së mbulimit universal të shërbimeve shëndetësore, mbi 300 mijë qytetarë, pjesë e 80 mijë familjeve të varfra, pra në nevojë ose me të ardhura të pakta, përfituan dhe përfitojnë kujdes mjekësor falas nga mjeku i familjes.

Kur i dëgjojmë në tryezë, duken sikur janë shifra, por në terrenin e përditshëm familjar është totalisht vëmendje ndaj qytetarëve dhe në këtë rast, vëmendje ndaj qytetarëve në nevojë. 300 mijë qytetarë, të cilët nuk kanë mundësi, kanë përfituar shërbim falas nga mjeku i familjes. 600 mijë qytetarë të pasiguruar përfitojnë nga vizitat falas te mjeku i familjes dhe tarifat e ulura në kujdesin shëndetësor të specializuar, si dhe nga skema e rimbursimit falas.

Mos harroni që këta 600 mijë qytetarë shqiptarë, për shkaqe të ndryshme, në jetën e tyre nuk kanë pasur mundësi të sigurohen dhe janë lënë në mëshirë të fatit dikur. Sigurisht, kur diskutojmë nuk duhet të harrojmë kurrë se kemi shumë për të bërë dhe jemi akoma larg pritshmërisë së tyre, por mos harroni se këta 600 mijë qytetarë para disa vitesh kanë qenë në mëshirë të fatit dhe sot ata janë brenda skemës së shërbimit shëndetësor dhe përfitojnë rimbursim të medikamenteve brenda skemës së rimbursimit.

Që prej vitit 2015 ofrohet falas shërbimi parandalues dhe diagnostikimi i hershëm i sëmundjeve për të paktën 480 mijë persona, me kontroll periodik. Sigurisht, është rritur edhe ofrimi i shërbimit parësor nëpërmjet zgjerimit të medikamenteve, numri i të cilëve ka shkuar në 500.

Dua të jap edhe një përgjigje për atë gënjeshtër të madhe (dhe më vjen keq që deputetët e opozitës nuk janë këtu) kur thonë “shpenzimet e luksit”.

Shpenzimet për pajisje dhe mobilim zyrash janë planifikuar në 342 milionë lekë. Pra, e shikoni të vërtetën? Ky është buxheti i shtetit nga thesari, pra planifikimi dhe pastaj zbatimi ose vetëm 0,6% e totalit vjetor të investimeve të brendshme prej 55 miliardë dhe akoma më pak e totalit të investimeve. Për periudhën 7-mujore ato janë realizuar në nivelin faktik 76 milionë lekë ose vetëm 22% e planit kundrejt nivelit të faktit total të investimeve të brendshme, që janë realizuar në 22,3 miliardë.

Shpenzimet për rikonstrukcion dhe ndërtim zyrash, boloria e gënjeshtres së përditshme, për vitin 2018 janë planifikuar gjithsej 647 milionë lekë ose vetëm 1,17% e totalit vjetor të investimeve të brendshme prej 55,17 miliardë. Për periudhën 7-mujore ato janë realizuar vetëm 545 milionë lekë.

Pra, e kuptoni se çfarë gënjeshtre del përditë për veshët e qytetarëve? Ku janë 110 milionë dollarët?

A t'ju them edhe diçka tjetër që ka të bëjë me blerje makinash? E dini, të dashur qytetarë, se çfarë quajnë blerje makinash për luks? Blerjen e flotës së Agjencisë Kombëtare të Ushqimit, në funksion të luftimit të informalitetit në sigurinë ushqimore. Nëse këta njerëz janë kundër sigurisë ushqimore, dakord, le ti quajnë makina në funksion të luksit. Janë makina të inspektorëve të AKU-së, që shkojnë derë më derë nëpër dyqane, nëpër magazina, për të ruajtur çdo ditë e më tepër kujdesin e qytetarëve në funksion të sigurisë ushqimore. Këto janë shpenzime luksi?! Apo kjo është një gënjeshtëri e madhe? Desha ta sqaroja, sepse përditë dëgjojmë bolorinë e fjalëve. Këto ishin disa nga...

Dua të bëj edhe një sqarim për sa i përket atij mitit të rrugëve. Besoj se kryetari do ta ma japë edhe një herë tjetër mundësinë për të referuar, por do t'ju jap vetëm dy shifra, pastaj mund t'ju jap edhe me projekte kilometrat e rrugëve të nisura, që nuk përfunduan deri në 2013-n, në fillim të mandatit 2013, për të krahasuar atë “rrugë, rrugë, rrugë”, “Tendera, tendera, tendera!” Jo rrugë, por bënë tendera. Hapën tendera edhe nga 1 mijë dollarë, edhe nga 10 mijë dollarë, për 20 milionë e 200 milionë euro dhe punët u bënë... 2013-2017, faktet janë kokëforte. Në fillim të mandatit në 2013-n, pra kur qeveria “Rama 1” mori detyrën, ishin 67 kontrata të hapura, por puna ose kishte filluar në 2-3 %, ose nuk kishte filluar fare. Ishin 344 kilometra rrugë të tenderuara, por jo të bëra zero. 46 kontrata të kolauduara, por të palikujduara, për 208 kilometra rrugë.

Dhe unë po ju them që në fund të mandatit tonë të parë janë likujduar të gjitha kontratat e lidhura para fillimit të mandatit tonë dhe janë përfunduar, janë kolauduar 39 kontrata ose vetëm nga këto të kufizuara 320 kilometra rrugë dhe të tjerat janë në vazhdim. Pra, ai miti të bërë “bënë rrugë, bënë rrugë”, në fakt nuk kanë bërë asnjë rrugë! E lanë gjithë Shqipërinë me rrugët të bëra copa-copa, pa sinjalistikë, diku e asfaltuar e diku jo, diku me një korsie dhe diku me gjysmë korsie, dhe u mburrën me atë që nuk e kishin bërë.

Faleminderit!

Këtu po e mbyll prezantimin tim dhe mirëpres komente ose pyetje.

Faleminderit.

Erion Braçe – Fjalën e ka zoti Anastas Angjeli, relatori i komisionit lidhur me aktin normativ.

Anastas Angjeli - Përshëndetje të gjithëve, të nderuar kolegë!

Sot ne po diskutojmë ndryshimet që i bëhen buxhetit të vitit 2018, natyrisht nëpërmjet një akti normativ. Në fillim dua të theksoj, pa dashur të përsëris panoramën e dhënë mbi situatën ekonomike, se ndryshimet buxhetore vijnë në kushtet e një klime ekonomike pozitive; në kushtet e një klime të stabilitetit dhe konsolidimit të vazhdueshëm financiar; në

kushtet e një ruajtjeje të stabilitetit makroekonomik dhe natyrisht të një performace pozitive në drejtim të aktorëve kryesorë, që kanë luajtur një rol dhe ndikim në rritjen e ekonomisë, në përmirësimin e situatës së punësimit dhe në ruajtjen e vazhdueshme të ritmit të rritjes ekonomike të krahasuar me programin e një viti më parë apo të disa vjetëve më parë. Kësisoj, duke mos dashur të përsëris të njëjtat shifra dhe tabela që u paraqitën nga ministri, të cilat tregojnë klimën pozitive nga vjen ky ndryshim, më lejoni të them disa konsiderata dhe t'u përgjigjem disa pyetjeve, që tashmë janë bërë të zakonshme dhe të përvitshme. Pse vijmë me një akt normativ? Pse e ndryshojmë buxhetin në mes të vitit? A duhet ndryshuar? Çfarë elementesh pozitive sjell ndryshimi i buxhetit në mes të vitit?

Natyrisht, këtu do të gjejmë përgjigje edhe pyetjet: sa i mbështetur në ligj është ndryshimi që ne bëjmë? Cili është fokusi kryesor i këtij ndryshimi?

Veprimet që kryhen për ndryshimin e buxhetit, si akti më kryesor i shtetit si nga pikëpamja financiare, ekonomike, juridike, por edhe sociale, veçanërisht në rastin konkret, janë të bazuara në Kushtetutë, në ligj, si dhe në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë. Kështu, mbështetja ligjore që u bëhet ndryshimeve është pa dyshim një garanci për t'i bërë këto ndryshime gjithnjë në sensin pozitiv.

Së dyti, momenti më i rëndësishëm i gjithë këtij ndryshimi është dhënia e përgjigjes ndaj pyetjes: a nuk është më mirë që ne t'i ndryshojmë treguesit kryesorë, të cilët i kemi miratuar 6 muaj më parë apo një vit më parë, në dhjetor të vitit të kaluar, për planin financiar të shtetit, për buxhetin e shtetit, që janë të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe më e rëndësishme deficitin buxhetor? Natyrisht, ky akt nuk i prek këta tregues kryesorë, përkundrazi, me ndryshimet që ne i bëjmë, i garanton dhe i konsolidon më tej këta tregues.

Pyetja e tretë: a është më mirë t'i lemë situatat ekonomike dhe fiskale të rrjedhin sipas atij parashikimi që kemi bërë pa konsideruar ndikimet e zhvillimeve ekonomie dhe fiskale të brendshme, qoftë dhe të paparashikuara, si është çështja e kursit të këmbimit me euro apo me faktorë të tjerë, qoftë edhe të ndikimit të ekonomisë së jashtme me ekonominë tonë (siç dihet zhvillimet kanë qenë dhe mbeten të vrullshme në këtë 10-vjeçar) apo është më mirë që t'i menaxhojmë ato me kujdes, duke i ndjekur gjatë gjithë periudhës dhe të bëjmë ndryshimet e duhura të brendshme apo rialokimin e fondeve, me qëllim që të marrim maksimumin e eficiencës nga përdorimi i këtyre fondeve? A është më mirë t'i lemë këto fonde, siç mund të shprehemi në gjuhën popullore "të digjen", ose të mos shfrytëzohen në disa drejtime investimesh, ku efienca dhe performanca nuk kanë qenë siç duhet apo t'i orientojmë atje ku performanca apo përdorimi i këtyre fondeve ka qenë maksimal dhe ende është e mundur për të dhënë potenciale zhvillimi më të madh? A është më mirë që këto fonde

t'i sigurojmë gjatë 7-8 muajve të parë të vitit, në mënyrë që t'i përdorim, apo nuk duhet t'i përdorim? T'u drejtohem shtresave në nevojë dhe moshës së tretë për t'i shpërblyer ata në fund të vitit apo t'i lejnë këto fonde dhe të mos i përdorin? Si është më mirë t'i riallokojmë brenda disa institucioneve disa fonde për t'i përdorur më me efektivitet apo të mos i përdorim? Natyrisht për të tria këto pyetje përgjigjja është po, duhet t'i bëjmë këto ndryshime dhe aq më tepër kur ato i bazojmë në Kushtetutë dhe në ligj.

Ne nuk duhet të tregohemi të ngurtë, ne duhet të tregohemi kushtetues, ligjor, por fleksibël aq sa na lejojnë këto akte kryesore ligjore të shtetit për të bërë përmirësimet e nevojshme. Pra, duke qenë se vijmë në një klimë ekonomike dhe fiskale shumë pozitive, duke qenë se ndryshimet që ne sjellim nuk prekin treguesit kryesorë, por bëjnë një axhustim, rialokim, menaxhim të atillë që na premtojnë një konsolidim të mëtijshëm të klimës ekonomike dhe asaj fiskale atëherë pa dyshim që ne duhet ta mbështesim atë. Ndryshimet që vijnë me këtë akt normativ janë pa dyshim ndryshime që bazohen në ato argumente që përdora pak më sipër dhe së pari, ato ruajnë të pandryshuar treguesit kryesorë të buxhetit që ne kemi parashikuar në fillim të vitit.

Siç u theksua, këtu ndryshim thelbësor është miratimi i një fondi për shpërblimin e pensionistëve, 3 miliardë, por po t'i shtojmë edhe pjesën e familjeve në nevojë, kjo përbën një paketë solidariteti të konsiderueshme, çka bazohet edhe në programin e qeverisë për vitin 2018.

Gjithashtu, riallokohen shpenzimet kapitale me argumentin që ju përmenda pak më sipër për projektet me ecuri të ngadaltë, duke i orientuar ato në avancimin e projekteve veçanërisht në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, të arsimit profesional, në sektorin energjik apo për fondin e zhvillimit të rajoneve. Është e qartë që në gjithë këtë rimenaxhim dhe rikonsiderim të buxhetit bëhen riallokime në zonat e shpenzimeve korrente dhe kapitale për të akomoduar nevojat që u kanë dalë disa institucioneve, Gardës së Republikës, Policisë së Shtetit dhe ndryshime të tjera, të cilat janë të nevojshme duke parë situatën që është krijuar.

Natyrisht, rritja ekonomike, zhvillimet makro-ekonomike, të gjitha këto besoj se gjejnë një mbështetje nëpërmjet këtij dokumenti, i cili sjell ndryshimet që u paraqitën pak më lartë dhe kështu do të garantohen edhe treguesit makro-ekonomikë, duke ruajtur objektivin e rritjes ekonomike, të inflacionit, të defixhitit. Pa dyshim që prioritetet nuk ndryshojnë ato mbeten në qendër të këtij dokumenti dhe ashtu siç është përcaktuar që në fillim reformat strukturore në fushat prioritare, si dhe mbështetja e prioriteteve ekonomike në energji, në menaxhimin e financave publike, në sektorin e bujqësisë, në menaxhimin e borxhit publik

janë dhe mbeten prioritete të pjesës në vazhdim, të pjesës së dytë të vitit bazuar në këtë dokument.

Është e qartë që ky dokument kërkon vazhdimësinë e punës për mbështetjen e tij nëpërmjet përmirësimit të punës në administrimin tatimor të organeve fiskale, në rritjen e tyre të përgjegjësisë për menaxhimin financiar dhe kontrollin, duke bërë punë të vazhdueshme që të ndikojë në zgjerimin e bazës tatimore dhe të reduktimit të informalitetit, të evazionit fiskal që rrjedhimisht kanë çuar dhe do të çojnë në rritjen e të ardhurave të buxhetit dhe në forcimin e konsolidimit fiskal. Mbetet prioritet, çka dëshmohet edhe në rialokimet që bëhen në dokument, rritja e efikasitetit të shpenzimeve veçanërisht ajo e shpenzimeve kapitale sidomos në financat publike dhe forcimi i konsolidimit fiskal do të vazhdojë të thellohet më tej nëpërmjet masave për rritjen e të ardhurave, të shpenzimeve dhe për përmirësimin e menaxhimit të borxhit publik.

Njëherësh do t'ju thosha se i duhet kushtuar kujdes, sepse fundi i vitit po vjen dhe përqendrimi i mobilizimit dhe i mbledhjes së të ardhurave në muajt e fundit të vitit do ta shtojë më tepër intensitetin e punës së organeve fiskale me qëllim që objektivat e vendosura në dokumentin kryesor me ndryshimet e bëra të jenë pa dyshim të arritshme plotësisht në fund të vitit.

Mendoj se akti normativ është një dokument ligjor dhe i argumentuar plotësisht, prandaj për këtë arsye do t'i ftoja kolegët e mi ta mbështesim sot edhe në Kuvend këtë dokument.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Angjeli!

A ka pyetje?

Urdhëroni, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit, kryetar!

Falënderoj Ministrin për prezantimin e një situatë makro-ekonomike të favorshme, e cila na bën të mendojmë për rregullimin e disa problemeve, apo për ta ndihmuar ekonominë tani që kemi edhe erën në favorin tonë.

Doja të flisja për dy tema.

E para, për turizmin dhe për mbivlerësimin e lekut. Turizmi po shikohet gjithmonë e më shumë si një motor i ekonomisë.

Erion Braçe- Më falni, zoti Bushati, a keni pyetje?

Ervin Bushati – Po bej parashtrimin, pastaj po bëj pyetjen.

Erion Braçe- Ju thatë se doni të flisni për dy çështje.

Ervin Bushati - Pra, së pari, meqenëse turizmi po kthehet në një motor të ekonomisë shqiptare, sa jemi të përgatitur ne për këtë? Ne bëmë ndryshime fiskale dhe strukturore, që kanë të bëjnë me formalizimin e ekonomisë në turizëm, si ndikuan ato?

Në funksion të turizmit, jo vetëm për t'i shërbyer atij, por edhe për t'i paraprirë zhvillimit zonat që ne i mendojmë me potencial si kanë ecur në përqindje? Si po i paraprijnë? A ka studime strategjike?

Rritja ekonomike me 4,45%, masat që ka marrë Banka e Shqipërisë, deeuroizimi, investimet e huaja, që thoni se do të shkojnë deri në 1 miliardë euro, patjetër që do të sjellin një mbivlerësim të parasë, dhe kjo na kthen te një situatë që njihet në ekonomi si sëmundja holandeze ku patjetër që afektohen eksportet, për shembull, bëhen më të shtrenjta, por, nga ana tjetër, ka efekte shumë të mira pozitive, konsumi ndihmohet, se shumica e mallrave që vijnë në Shqipëri vijnë nga importi dhe blihen me euro, pra rritet fuqia blerëse, kjo e rrit konsumimin.

Unë kam tri shqetësime, së pari, cilat janë masat për të stimuluar eksportet? Si i parashikon qeveria, sepse do të vazhdojë të ndodhë kjo, pavarësisht se nuk duhet të hutohemi nga ato që thotë opozita se jo janë para kështu, jo janë ashtu. Ky është një proces normal që duhet ta parashikojmë që do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Si do t'i mbrojmë eksportet shqiptare?

Së dyti, sa i përket inflacionit, nëse fuqia blerëse e lekut vazhdon dhe rritet dhe bien çmimet, fillon të ndikojë te inflacioni, i cili do të bjerë nën potencial, do të shkojë mbase edhe nën 2%. Gjithashtu, cili është parashikimi juaj në të ardhmen për të ardhurat, sepse ju thatë se ju mungonin 3,5 miliardë lekë pasi ka rënë euro. Le të bjerë euro, nuk kemi asnjë shqetësim, nëse do të binte leku do të kishte shqetësim për ekonominë tonë, por kjo do të ndikojë në të ardhurat në vitet e mëpasshme. Si mendohet të gjendet dhe ku do të zëvendësohen këto fonde?

Erion Braçe – Po, zoti Ministër.

Arben Ahmetaj- Unë do të jap disa fakte të reja që janë ende në nivel operativ, sigurisht të turizmit, së pari, është rritur formalizimi dhe për herë të parë vetëm në disa zona, që ne i referohemi si zona që tërheqin shumicën e turizmit, ka një formalizim gati, 5,6 miliardë lekë qarkullim.

Në përqindje të totalit shifrat ende janë operative. Ndërkohë vetëm nga reduktimi i TVSH-së, sipërmarrja në turizëm ka përfituar atë që është 14%, 826 milionë lekë, pra që do t'i paguante në buxhet të shtetit, por që i ka mbajtur në funksion të operacioneve të veta, ka rritur marzhin e fitimit dhe ka ulur madje edhe çmimet. Në logjikën e aktivitetit turizmi është

në themel të investimeve kombëtare, por edhe rajonale. Dua të sjell në vëmendjen tuaj tri projekte që ne po bëjmë me 3 donatorë të ndryshëm:

I pari, është me Bankën Botërore që shkon te 74 milionë dollarë që investon tërësisht në unazën e turizmit në jug, duke filluar që nga Apollonia, zbret në breg deri në Sarandë në Gjirokastrë dhe në Berat me investime të drejtpërdrejta në funksion të turizmit.

I dyti, për të cilin sapo kemi përfunduar një negociatë me Bankën Botërore, e cila do t'i referohet konektivitetit të turizmit me një paketë 50 milionë dollarë, plus 50 milionë dollarë, një kombinim i Bankës Botërore me BERZH-in, që do të shkojë në të njëjtin drejtim dhe tani po detajohet. Edhe ky projekt do të fokusohet te konektiviteti, te përmirësimi i infrastrukturës për turizmin.

I treti është në inicim si paketë midis BERZH-it dhe Komisionit European për 60 milionë nga BERZH-i, kredi e butë, dhe 40 milionë euro grant nga Bashkimi European, nga Komisioni European. Edhe kjo shumë do të fokusohet drejtpërsëdrejti tek investimet në funksion të turizmit.

Në të njëjtën kohë, siç e thashë, të gjitha projektet nacionale të infrastrukturës qoftë rrugore, qoftë e ujit, utilitetet kanë një sërë projektesh qoftë në vazhdimësi tani, qoftë të parashikuara, mund të sjellë atë të zonës së Himarës me KfW-në. Për zonën e Durrësit kemi projektin e Bankës Botërore që për herë të parë në historinë e asaj zone do të çojë ujin deri sipër në limitin ekstrem verior të Gjirit të Lalzit, që konceptohet zonë me përparësi turizmi. Sigurisht që ka ndërhyrje të Fondit Shqiptar të Zhvillimit nëpërmjet dy programeve: programit të vet buxhetor dhe atij buxhetor të FZHR-së, të cilat janë ndërhyrje të targetuara, kryesisht janë të fokusuara te “100 fshatrat” apo te zona me përparësi turizmin. Ka nevojë për shumë e më shumë fonde dhe shumë e më shumë punë në këtë fazë që jemi. Siç iu referova edhe numrave të turizmit, kanë rritje të konsiderueshme. Mendohet se do të kalojë kontributi, të hyrat nga turizmi do të jenë mbi 2 miliardë euro këtë vit, që është një kontribut shumë i rëndësishëm në ekonomi. Paketa e investimeve publike do të vazhdojë akoma më shumë të fokusohet në akset kryesore rrugore për të krijuar shtyllën kurrizore të fortë Veri-Jug të transportit rrugor. Ka projekte qoftë hekurudhore, qoftë të ndërtimit të aeroporteve. Ka një negociatë të avancuar për aeroportin e Kukësit për ta futur në operim. Është një negociatë në vazhdimësi për aeroportin e Vlorës.

Pyetja e dytë, ishte për eksportet shqiptare. Këtu ka një diskutim në parim, ka edhe një diskutim teknik. Diskutimi në parim është: a do të ndërhyjmë apo jo? Unë nuk besoj se këtu ka njeri që të thotë: “po ne duhet të ndërhyjmë te kursi i këmbimit”. Ky do të ishte një gabim, qoftë parimor, qoftë teknik. Ka edhe një arsye përtej kësaj, që vlerësimi i lekut

është për shkak të përmirësimit të fondamenteve ekonomike, nuk është një mbivlerësim artificial që të fillojmë të shqetësohemi. Lëkundjet janë plus, minus aty ku Banka e Shqipërisë me të dyja metodologjitë e saj teknike ka parashikuar trajektoren e kursit të këmbimit. Po të shikoni, me gjithë mbivlerësimin, eksportet janë të rritura në nivelin 16-17%, rekord. Nuk ka pasur vit që eksportet të kenë qenë të tilla. Kemi nevojë që ta zgjerojmë gamën, të garantojmë tregjet, por unë po bëj një reflektim shifror. Në njërën anë është mbivlerësuar leku dhe në anën tjetër megjithëse është mbivlerësuar leku, teorikisht dhe praktikisht do të thoshin se është rritur kostoja e produkteve shqiptare, ekonomia shqiptare, aktorët shqiptarë të prodhimit i kanë rritur volumet e tyre të eksporteve dhe në destinacione të ndryshme, kjo tregon se kanë rritur konkurrueshmërinë dhe produktivitetin. Referenca e drejtpërdrejtë e asaj që ju i referoheni është rritja e konkurrueshmërisë dhe e produktivitetit. Ka një pyetje fare të thjeshtë: nëse është shtrenjtuar malli për eksport për shkak të mbivlerësimit, cila është arsyeja që t'ju rritet 16,3%, në mos gaboj? Arsyeja është fare e thjeshtë, është në dy korsi. E para, ke rritur konkurrueshmërinë dhe produktivitetin dhe je bërë më i zgjuar në gjetjen e tregjeve. Përtej kësaj thjeshtësie ka një mal me punë që kanë bërë aktorët ekonomikë. Nuk diskutohet. Shteti me lehtësira, qoftë në zero taksa eksporti, qoftë në procedura fare të lehtësuara, qoftë edhe në rimbursimin brenda 30 ditëve automatik. Mund të ketë probleme aty-këtu, natyrshëm në përmirësimin administrativ, por parimi dhe e përgjithshmja është kjo që ju referova. Logjika që të mbrosh eksportin, ka shumë instrumente indirekt, por thelbi është te produktiviteti dhe konkurrueshmëria. Ajo nuk vjen duke qenë proteksionistë, por përkundrazi ajo vdes, po të bëhemi proteksionistë ajo vdes. Konkurrueshmëria dhe produktiviteti nën hijen e proteksionizmit merr fund dhe mund të japë fryt një ditë, por ditën e dytë, të 10, të 100 janë në kundërshtim me logjikën e konsumatorit, me produktivitetin e rritur, me inovacionin dhe me konkurrueshmërinë. Detyra jonë është vetëm t'i lehtësojmë, t'i bëjmë procedurat të thjeshta, t'i bëjmë të ulëta të gjitha ngarkesat fiskale që ka sipërmarrja shqiptare dhe të punojmë për përmirësimin ekonomik. Një platformë e rritur ekonomike i ngre të gjithë aktorët.

Për sa i përket inflacionit është interesante t'ju them se është Banka e Shqipërisë, autoriteti përgjegjës, nuk është Ministria e Financave. Ne jemi autoriteti fiskal. Me gjithë ato që iu referuam së bashku inflacioni ka një *up swing* nga 1,9 ka shkuar në 2,4 Mund të ketë efekte sezonale, sigurisht, por nuk e ka ulur pulsën. Kjo bën që indirekt të mendojmë deri kur të dalin shifrat se pulsë ekonomik është përshpejtuar. Rritja ekonomike është përshpejtuar. Kjo është dhe një nga arsyet: konsumi në rritje, tregtia në rritje, sektorët të

gjithë po t'i shikosh janë në rritje. Më në fund edhe bujqësia upswing, tregon se pulsi ekonomik është përshpejtuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rakordimi për të ardhurat...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal! Jo, nuk do të iki me atë mendje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, nuk na takon ne. Sigurisht, ju e kuptoni mirë se një element është edhe balancimi i bazës nga viti në vit. Pra, baza po balancohet.

E dyta është rritja e efektivitetit të administratës. E treta është rritja ekonomike. Tek e dyta është thellimi në instrumentin e riskut brenda administratës fiskale. Për shkak të metodologjisë së re që po përdorim, duke e futur tek TVSH-ja nipt më nipt, po shohim një reagim pozitiv të TVSH-së në dy muajt e fundit, pra në rritje.

Unë besoj se do ta ruajmë ritmin e konsolidimit dhe ritmin e rritjes së të ardhurave, dhe ajo çka është më e rëndësishmja, unë besoj se në fund të këtij viti, pikësëpari ne do të kemi ulur borxhin, pa eurobondin, në 67, 5 %, do të kemi ruajtur nivelin e deficitit të përgjithshëm në 2 %, dhe për të tretin vit radhazi do të vazhdojmë të jemi me balancë primare pozitive.

Pra, këto të tria janë të panegociueshme.

Faleminderit!

Erion Braçe – Po, zonja Kushi!

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

Unë kam një pyetje që lidhet me çështjen që po diskutojmë. Së pari, shumë shkurt desha të them se për këtë sesion të ri, sot është mbledhja e parë e Komisionit për Ekonominë dhe Financat, dhe shpreh keqardhjen që opozita nuk është e pranishme në këtë mbledhje. Jo vetëm për faktin se një fillim i mirë sot do të ishte sinjal për mbarëvajtjen e punëve në këtë sesion të ri, por edhe për faktin se sot po diskutojmë një çështje shumë të rëndësishme.

Në qoftë se ka një ligj, i cili është absolutisht më i rëndësishmi nga të gjithë për këtë komision, është pikërisht ligji që lidhet me buxhetin. Çdo rishikim i buxhetit apo çdo hartim për buxhetin e vitit pasardhës, çdo vlerësim apo analizë e buxhetit faktik të vitit paraardhës, janë çështje që duhet ta bëjnë të ndjehet me më shumë përgjegjësi çdo deputet të këtij komisioni, për të qenë i pranishëm e për të dhënë kontributin e tij. Kështu, duke shpresuar se opozita do të vijë në mbledhjet e ardhshme, po kaloj te pyetja që kam lidhur me çështjen që po diskutojmë.

Zoti Ministër, shumë faleminderit për prezantimin tuaj! Na dhatë vërtetë një panoramë të gjerë për të kuptuar situatën ekonomike e financiare.

Pyetja ime lidhet me detyrimet e prapambetura. Të gjithë e dimë se ky ka qenë një nga problemet më të mëdha që ne gjetëm në vitin 2013, trashëguar nga qeveria paraardhëse. Madje, në dy vitet e para të mandatit të parë ne na u desh të rikuperonim dhe të shlyenim pikërisht detyrimet e prapambetura ndaj bizneseve private. Pyetja ime ka të bëjnë me këtë. Si është situata sot? A ka akoma akumulim detyrimesh të prapambetura? A ka sektorë që janë problematikë? Nëse ka detyrime të prapambetura, ky akt normativ që ne po miratojmë sot a garanton që këto të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit për pyetjen!

Pushteti vendor vazhdon të ketë detyrime të prapambetura, me gjithë qasjen shumë të afërt të Ministrisë së Financave për reduktimin e tyre. Janë reduktuar patjetër, janë në reduktim e sipër një pjesë e mirë e detyrimeve të tyre, kjo edhe për shkak të aplikimit për herë të parë këtë vit të ligjit të financave vendore, për shkak se brenda ligjit të financave vendore po aplikojmë për qeveritë vendore të njëjtat standarde të financave publike, me të cilat kemi detyruar qeverinë qendrore. Kjo do të çojë diku me shpejtësi, diku me më pak shpejtësi në reduktimin total të detyrimeve.

E dyta, që nuk e thashë në lidhje me rrugët, por po e them tani: për rrugët kemi pasur në momentin 12, 5 miliardë detyrime, minimalisht, të verifikuara me fatura.

Sot, në vitin 2017, kur mbyllëm vitin fiskal, totali i detyrimeve të prapambetura ishte maksimumi tek 1 miliard, dhe me detyrim nga Ministria e Financave për ministrinë e linjës, që brenda buxhetit të vitit 2018 t'i ezauronte të gjitha. Edhe në bazë të ligjit, ministria ka mundësi të vendosë kushte. Praktikisht u shlyen.

Kjo do të thotë se ne kemi adoptuar atë, së cilës ne i referohemi si zero tolerancë ndaj detyrimeve të prapambetura. Sigurisht, ka sektorë të cilët, edhe për shkak të kohës fizike të projekteve që krijojnë, po i krijojnë të vogla. Ka një përmirësim të ndjeshëm të TVSH-ja për katër projektet e mëdha të akumuluar në pesë e në shtatë vjet, si për shembull ENN Energy, praktikisht, edhe për pak e ishte rreth 42 milionë dollarë, të krijuara këtu e shtatë vjet. Besoj se edhe dy tre rimbursime, dhe praktikisht është e shlyer e gjitha. Të njëjtën gjë kemi me Bankers-in, të njëjtën gjë kemi me TAP-in.

Një shifër për rimbursimin mund t'ju them: vitin e kaluar, në mos gabohem, kemi rimbursuar 160 milionë dollarë, në krahasim me 80 milionë dollarë e 100 milionë dollarë. Gati dyfish.

Ka edhe një element tjetër, që është në reduktim, por edhe për shkak të inventarizimit të tyre: janë në përgjithësi gjyqet e administratës, të cilat përbëjnë një shifër, që nuk dua ta them, të neglizhueshme. Nuk janë shifra të neglizhueshme dhe të mëdha, por edhe ato janë në reduktim e sipër.

Erion Braçe – Urdhëroni, zoti Xhakolli!

Ilir Xhakolli – Pamë pasqyrën e bonusit për pensionistët, e cila për 4 vjet është dhënë me akt normativ. Unë kam një pyetje: a mundet ta planifikojmë atë që në buxhet për të shuar edhe zërat që këtë bonus e quajnë si lëmoshë për pensionistët? Përderisa e kemi dhënë çdo vit, ta planifikojmë që në buxhet.

Arben Ahmetaj – Rëndësi ka që të japim çdo vit, siç e kemi dhënë dhe siç e kemi vendosur në programin e qeverisë së PS-së.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, rëndësi ka që ta japim çdo vit, ashtu siç e kemi shkruar dhe siç e kemi vendosur në programin e qeverisë së PS-së kur kemi bërë fushatë në vëmendje të qytetarëve. Patjetër që do ta japim.

Erion Braçe –Faleminderit!

Zoti Ministër, kam unë disa pyetje lidhur me aktin normativ, por edhe lidhur me zhvillimet ekonomike gjatë vitit 2017 dhe gjatë këtyre 8 tetë muajve të parë të vitit 2018. Po e filloj me buxhetin.

Në fakt, ju iu përgjigjët një pjese të konsiderueshme të shqetësimeve, madje edhe të pretendimeve, në pjesën më të madhe të ngritura abuzivisht për nevojat e propagandës. Gjithsesi, më mirë që u sqaruan të gjitha. Ajo që më intereson mua, në përmbushje të ligjit për buxhetin dhe detyrimeve që ka Kuvendi, por edhe ky komision lidhet me pagesat që janë bërë nga buxheti i shtetit për kontratat koncesionare gjatë këtyre 6 muajve të parë të vitit, a jemi brenda parametrave të përcaktuar në ligjin e buxhetit të shtetit dhe si do të vijojnë ato deri në fund të vitit?

Së dyti, u kam hedhur një sy atyre që i quani rialokime brenda shpenzimeve të institucioneve kryesore të vendit. Natyrisht, kam disa shqetësime.

Së pari, për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ju thatë se më në fund edhe bujqësia kërceu me një rritje, e cila për mua mbetet ende e vogël për shkak të gjerësisë së sektorit dhe njerëzve të zënë me punë në bujqësi, të çmimeve të ulëta, natyrisht edhe produktivitetit të ulët. Dua të di pse janë cenuar disa prej zërave kryesorë të shpenzimeve të Ministrisë së Bujqësisë. Ka pasur vonesa, mosrealizime, të cilat lidhen drejtpërdrejt me punën në atë sektor, apo janë konsideruar shpenzime të padobishme?

Së dyti, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë kam pothuajse të njëjtën pyetje për preken në ulje të disa zërave të shpenzimeve, veçanërisht në transportin rrugor, për transportin hekurudhor e kuptoj, i cili është prekur me gati 503 milionë lekë të rinj. Dua të di edhe këtu arsyen. Ndërkohë, në rritje shikoj dy zëra: menaxhimin e mbetjeve urbane dhe në krahun tjetër na jep edhe mbështetje për energjinë, pavarësisht se këta 8 muaj, me thënë të drejtën, kanë qenë shumë të mira për prodhimin e energjisë elektrike dhe për eksportin e energjisë elektrike. Kështu që dua një arsye edhe për këta dy zëra.

A mund të na e shpjegoni preken prej 4,6 miliardë lekësh minus në Ministrinë e Financave? Te Ministria e Financave zëri “Sigurime shoqërore” preket me 4,6 miliardë lekë. Dua të di arsyen pse ka ndodhur kjo prekje.

Ndërkohë, edhe te Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale prekja është domethënëse në ulje, veçanërisht në zërin “Përfshirje sociale”, ashtu si edhe në dy zëra që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me shërbimin shëndetësor, qoftë parësorin, qoftë dytësorin. Dua të di arsyet pse janë prekur këta dy zëra të kujdesit parësor dhe të kujdesit dytësor, që shkojnë gati 800 e kusur milionë lekë. Po kështu, edhe përfshirja sociale ulet me 130 milionë lekë.

Po kaloj te 2-3 institucione të rëndësishme kushtetuese. E para, Kontrolli i Lartë i Shtetit, siç ju e dini, vepron me një ligj që i ka dhënë sovranitet të kufizuar nga Kuvendi dhe jo nga qeveria për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të tij, është prekur me minus 30 milionë lekë.

Ndërkohë, po kështu është prekur me minus 60 milionë lekë edhe buxheti i Zyrës së Administrimit Gjyqësor. Dua një shpjegim edhe për këtë.

Ajo që më shqetëson më shumë se të parat ka të bëjë me buxhetin e institucioneve të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në sistemin e drejtësisë. Zoti Ministër, në këto institucione është krijuar një volum i jashtëzakonshëm pune për të përballuar detyrimet prioritare për të paktën një numër prej 57 gjyqtarësh dhe prokurorësh, që ishin në proces rivlerësimi. Në dijeninë time ky proces po përfundon dhe punonjësit në ato institucione kanë punuar me orare të zgjatura, të cilat duhen paguar sipas ligjeve dhe kodeve në fuqi. Ndërkohë, vjen një masë, e cila është bërë efektive, me ulje prej 33 milionë lekësh. Kështu që dua edhe një përgjigje për këtë. Këto ishin pyetjet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me buxhetin.

Duke iu referuar atyre që ju thatë, por edhe disa zhvillimeve që kanë ardhur gjatë këtyre 8 muajve, kam këto pyetje:

Jo më larg se 3-4 ditë më parë është bërë publik raporti i Institutit të Statistikave për sektorin e ndërtimit dhe kryesisht të lejeve të dhëna për zhvillime të ndryshme të pronës apo të objekteve në këtë sektor dhe ajo që bie në sy është përqendrimi i parave apo i këtij sektori

kryesisht në Tiranë. Në tre muaj janë dhënë 11-12 miliardë lekë leje, pikërisht në Tiranë. Nuk më shqetëson ajo që shpeshherë, për nevoja të propagandës, artikullohet nga opozita, por më shqetëson diçka tjetër, ju, si ministër i Ekonomisë, a e shihni shqetësues faktin e përqendrimit në një sektor të vetëm, ose përqendrimin e parave në një sektor të rëndësishëm, siç është ky i ndërtimit dhe, në krahun tjetër, përqendrimin e parave vetëm në një qytet të Shqipërisë? A është në vëmendjen tuaj fakti se ky zhvillim i pabarabartë po krijon një problem të gjerë në territor, pikërisht në aspektin e zhvillimit?

Së dyti, është fare evidente që turizmi ka sjellë një përmasë tjetër të zhvillimit ekonomik të këtij vendi dhe natyrisht edhe të rritjes ekonomike, por ajo që mua më shqetëson dhe që dua të kuptoj, edhe nga ju si ministër i Ekonomisë, është se cili është trendi i rritjes së kapaciteteve të akomodimit në sektorin e turizmit, do të shkojmë drejt strukturave që më së shumti shiten, apo do të shkojmë drejt strukturave që akomodojnë?

Së treti, ju thatë që në borderotë e shtetit janë gati 690 mijë të punësuar. Pa asnjë diskutim që janë shumë më shumë se ç'kanë qenë deri në vitin 2013, shifrat janë evidente, por edhe njerëzit e punësuar janë evidentë dhe jo thjesht në bordero, por ajo që më intereson mua të di ka të bëjë me pagën mesatare.

Lidhur për pagën minimale, në ato trende që është përcaktuar, me vendime të ndryshme, jemi në dijeni, si ka evoluar nga viti 2013 deri sot dhe ku ne kemi arritur në këtë numër të rëndësishëm të punësuarish në vend?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Unë dua ta garantoj komisionin se brenda buxhetit afatmesëm 2018 dhe në vazhdim të gjitha detyrimet dhe pagesat për koncesionet dhe PPP-të do të jenë nën 5% të të ardhurave të një viti më parë. Për herë të parë është kjo qeveri, e cila ka futur detyrimin ndaj vetes për t'i bërë transparente të gjitha detyrimet. Pra, dua ta garantoj komisionin që pagesat për koncesionet nga ministritë e linjës, pra nga autoritetet kontraktore të ndryshme do të jenë të akomoduara brenda 5%-it, madje në distancë nga 5%-shi.

Po të marrim historikun e koncesioneve, është e rëndësishme ta themi, në qeverinë “Rama 1” janë bërë gjithsej 39 koncesione, ndërsa në qeveritë e kaluara janë bërë 180 koncesione. Dua t'i garantoj qytetarët dhe ju se kostoja në buxhet e atyre 180 koncesioneve, e drejtpërdrejtë ose indirekte, është shumë e madhe. A doni çmimin e energjisë, që vjen drejtpërsëdrejti si goditje në bilancin e OSHE-së dhe pastaj vjen direkt apo indirekt në buxhet të shtetit? A doni goditjen nga Rapiscani?

Erion Braçe – Po, sa janë?

Arben Ahmetaj – Po i them. Vetëm nga Rapiscani shkojnë gati 1,6 miliardë në vit, të planifikuara. Vetëm nga ndërtimi i rrugës së Devollit, të hidrocentralit, është 12 milionë dollarë në vit. Vetëm për shkak të çmimit të hidrocentraleve private goditja në bilancin e OSHE-së shkon deri në 35 milionë dollarë. Kush i paguan këto?! I paguajnë drejtpërsëdrejti tatimpaguesit. Pastaj diskutimi është se çfarë shërbimi marrin. Koncesionet që janë dhënë, si për shembull, dializa, *check up-i*, sterilizimi, pastrimi i mbetjeve dhe inceneratorët janë të gjithë me produkt të drejtpërdrejtë në favor të qytetarëve. 480 mijë qytetarë janë kontrolluar falas dhe infeksionet në spitale janë ulur me 25-30%. Të gjitha këto janë qëllime të drejtpërdrejta të këtyre projekteve, që në finale janë projekte publike, pavarësisht se janë PPP apo koncesione. Demonizimi i koncesioneve është bërë me qëllim, duke u fokusuar, me demek, vetëm te procedurat.

Ju solla si shembull Rrugën e Arbrit. Ja, kthejuni sot qytetarëve të Dibrës dhe thojini: “Po, të dashur qytetarë të Dibrës, buxheti nuk ka mundësi që t’ju bëjë rrugë”. Hajde t’ia themi se nuk kemi para t’u bëjmë rrugë, pra do të ngeleni atje edhe 25 vjet. Por çfarë bën një qeveri? Gjen një instrument. PPP-ja, koncesioni, është një instrument për ta sjellë rrugën më afër në kohë, në favor të qytetarëve.

Ajo që do të ishte rrugë pas 25 vjetëve, ju bëhet e mundur sot për tre vjet, por ka kosto. Është kostoja e parasë, por investim është. Shkoni e thojuni qytetarëve të Dibrës se ju nuk vleni për ne.

Jo, kjo është qeveri, kjo është maxhorancë, që e ka të gjithë vëmendjen te qytetarët, kudo ata janë, dhe u thotë: po. Janë shumë para 243 milionë euro? Por për një vend si ky edhe 1 lek, edhe 100 lekë, edhe 1 miliard lekë janë shumë dhe duhen harxhuar me zgjuarsì.

Çfarë do të më thotë mua opozita? Do të më thotë se duke harxhuar këto para nuk është zgjuarsì, sepse i kemi harxhuar për popullin e Dibrës? Le ta thotë! Jo, për këtë maxhorancë populli i Dibrës është shumë i rëndësishëm, madje është njësoj i rëndësishëm sa populli i Tiranës, njësoj i rëndësishëm sa populli i Vlorës; njësoj i rëndësishëm sa populli i Gjirokastrës; njësoj i rëndësishëm sa populli i Korçës. E për këtë arsye ato para po shkojnë në vendin e duhur, për të bërë Rrugën e Arbrit për qytetarët e Dibrës dhe të Shqipërisë.

Demonizimi i këtij koncesioni është i qëllimtë. Pse opozita shkon te procedura? Procedura është e hapur, në bazë të ligjit. Ajo procedurë ka qenë. Pse shkon atje? Shkon, sepse e tremb rezultati, e tremb produkti, e tremb vëmendja e kësaj maxhorance ndaj qytetarëve. Këto e trembin, prandaj ngrihet e thotë: “Kushton dy, kushton tre”. Kontrollon! Kostot kontrollohen. Aty do të jetë rruga, aty do të jenë letrat, aty do të jenë kostot.

Qytetarët e Dibrës meritojnë rrugën! Ky është thelbi i asaj së cilës ju i referoheni, pra PPP-ve dhe koncesioneve.

E përsëris, demonizimi është i qëllimshëm, është politik.

Në qoftë se te *check up*-i janë 480 mijë të kontrolluar falas në shëndetin e tyre, nëpërmjet thesit të madh të buxhetit, deri dje të paguanin, ndërsa sot nuk paguajnë. Por sa jetë janë shpëtuar? Kush nga këta që mungojnë këtu i vë çmim jetës dhe merret me procedurën?

Merret me procedurën për të demonizuar atë që kjo qeveri bën, sepse ka frikë nga vëmendja që kjo qeveri ka ndaj qytetarëve dhe kjo maxhorancë ka ndaj qytetarëve. Është vëmendje! Tani, unë nuk po them që çdo gjë të bëhet perfekte, pasi nuk është e mundur, sepse, e para, nuk jemi dot të tillë dhe, e dyta, nuk bëjmë dot gjithmonë e në vazhdimësi gjëra perfekte. Por shërbimi ndaj qytetarëve, kontrolli shëndetësor është falas dhe ka shpëtuar jetë! Kush nga këta i vë çmim jetës? Edhe sikur të shfrynin këtu, po të ishin, kush nga këta i vë çmim jetës? Le t'ia vënë.

Kush nga këta e dallon dot popullin e Tiranës dhe atë të Dibrës nga populli i Shkodrës dhe ai i Gjirokastrës? Kush nga këta?

Erion Braçe – Zoti Ministër...

Arben Ahmetaj – Unë po përgjigjem.

Erion Braçe – Në rregulla pra.

Arben Ahmetaj – Po vazhdoj përgjigjen.

Erion Braçe – Por nuk është pyetja ime kjo për të cilën po përgjigjeni.

Arben Ahmetaj – Unë kam përgjigjen time.

Erion Braçe – Zoti Ministër, ju lutem shumë, këta nuk janë këtu...

Arben Ahmetaj – Fakti shtatëmujor, zoti kryetar...

Erion Braçe – Po pra.

Arben Ahmetaj – ...është 5,1 miliardë, por unë nuk mënyrën time të përgjigjes, sepse ka shumë pyetje në publik dhe ky është një rast shumë i mirë për t'iu përgjigjur.

Erion Braçe – I vetmi problem që kam është se unë nuk bëj pyetje në emër të tyre, bëj pyetjet e mia.

Arben Ahmetaj – Unë përgjigjem në emër të qeverisë.

Erion Braçe – Këta kanë zgjedhur të mos jenë, është puna e tyre, as më intereson fare nëse vijnë ose jo! Mua më intereson të marr një përgjigje për ato pyetje që bëj.

Arben Ahmetaj – Por ne në moton tonë kemi...

Erion Braçe – Ekzistojnë ose jo këta, është çështje e atij që kanë për kryetar, nuk është çështja ime.

Arben Ahmetaj – Dakord, dakord.

Erion Braçe – Ai që kanë për kryetar i ka orientuar të mos jenë këtu.

Arben Ahmetaj – Dakord.

Erion Braçe – Tani, nuk mund t'i ngjallim me zor!

Arben Ahmetaj – Jo.

Erion Braçe – Viagra ka plot në tregje!

Arben Ahmetaj – E drejtë.

Erion Braçe – Po të duan, le të shkojnë atje, këtu nuk i sjell dot! Çfarë flasim tani?

Arben Ahmetaj – Duke qenë se vëmendja e kësaj maxhorance është totalisht ndaj qytetarëve, unë po i trajtoja jo si opozitarë, por si qytetarë që kanë nevojë për informacion.

Erion Braçe – A mund të më përgjigjeni mua, ju lutem?

Arben Ahmetaj – 5,1 miliardë në shtatë muaj.

Erion Braçe – Faleminderit!

Si jemi me këto 5,1 miliardë në raport me detyrimin buxhetor që kemi?

Arben Ahmetaj – Është afërsisht pak më pak se 70% e totalit.

Erion Braçe – Në rregull. Vazhdojmë me pyetjen tjetër.

Arben Ahmetaj – Për sa u përket alokimeve, po i përmbledh në një përgjigje, të gjitha alokimet janë bërë në diskutim të detajuar me ministrinë e linjës për shkak të performancës, qoftë te bujqësia... Pra, çdo ministër ka rënë dakord me ministrin e Financave dhe pastaj me Kryeministrin, patjetër, për të gjitha rialokimet. Kjo, siç e thashë, për shkak të performancës, ecurisë shtatëmuajore dhe parashikimit të tyre në përputhje me parashikimin tonë, pra qoftë te bujqësia, qoftë tek transporti rrugor...

Për shembull, tek transporti rrugor, procedurat e tenderimit nuk mbaruan dot në qershor, por besoj se kanë mbaruar, në dijeninë time, diku rreth gushtit. Sigurisht, kjo bën atë që shuma 503 milionë, së cilës iu referuat, të planifikohet që tani nga ministri dhe së bashku me ministrin e Financave, se nuk do të harxhohet dot deri në fund të vitit, çka rialokohet në një projekt, i cili natyrshëm mund të ketë ecur pak më shpejt.

Për sa i përket...

Erion Braçe – Zoti Ministër, më falni, një ndërhyrje të vogël këtu, se unë iu referova disa prej ministrive, por kjo që më thoni ju, se kjo vjen për shkak të performancës dhe është rënë dakord me ministrat e të tjerë me radhë, më shqetëson jashtë mase. Tani, unë po i referohem thjesht Ministrisë së Bujqësisë, meqenëse jam në një zonë përgjithësisht rurale dhe kam ndjekur zhvillimet në të. Ulja në këta zëra te Ministria e Bujqësisë më sjell ndër mend faktin se gjatë gjithë periudhës nga dimri deri në fund të pranverës zonat e Jugut të vendit

(dhe Jugu i vendit nuk fillon në Apoloni), duke filluar nga Shkumbini për të vazhduar deri poshtë në Gjirokastër, kanë kaluar një situatë shumë të vështirë në përballimin e reshjeve, gjë që do të thotë se hidrovorët kanë punuar me kapacitet maksimal edhe për shkak të nxehtësisë që erdhi menjëherë, edhe për shkak të kohëzgjatjes së vaditjes gjatë gjithë kësaj periudhe, drejtoritë që merren me menaxhimin e ujërave në të gjithë Jugun e vendit, kanë nevojë për shpenzime operative, për energji elektrike. Sot që flasim, janë bllokuar nga thesari dhe nuk kanë para për të paguar energjinë që kanë konsumuar në kohën e krizës së reshjeve. Nuk kanë. Normalisht, nuk kanë para as për deri në fund të vitit.

Unë nuk arrij ta kuptoj se si ka rënë dakord ministria me këtë ulje, kur këto drejtori kanë nevojë të përballojnë dhe sot që flasim, janë të bllokuara nga thesari, sepse nuk kanë paguar energjinë elektrike. Kaq e thjeshtë është. Si ulet kjo? Kjo është e para.

E dyta, nuk e kuptoj këtë historinë e Ministrisë së Transporteve. Unë ju them se rrugët kombëtare në territorin që mbuloj unë, janë pa mirëmbajtje që nga data 1 janar 2018. Kanë 8 muaj pa mirëmbajtje. Zero. Kanë shkuar ferrat nga 1,5 metra në çdo anë të rrugëve, pa folur për kanalet, gropat që janë krijuar etj. Po të doni, shkojmë bashkë dhe i shohim në vend.

Nuk e kuptoj se si ka rënë dakord ministri respektiv të ulë fondet e parave, në një kohë kur nuk ka mirëmbajtje për këto rrugë, sot që flasim. Çfarë efektiviteti paska përdorimi i parasë publike, kur për 8 muaj nuk bëtë dot tenderin? Për çfarë po flasim?

Unë bie dakord me ju që për shkak të performancës e për të tjerat me radhë kanë ndodhur këto, gjëra dhe u ulën fondet, por duhet të zgjidhen problematikat që janë krijuar për shkak të performancës atje poshtë, në territor. Përndryshe, çfarë kuptimi ka që ne të nxjerrim para nga buxheti i shtetit për të financuar këto projekte?

Arben Ahmetaj – Zoti Braçe,

Për dijeninë tuaj, bujqësisë nuk i është prekur asnjë gjë përveç fondit të garancisë me BERZH-in. Zero. Asnjë lek, vetëm fondi i garancisë me BERZH-in që është fondi i garancisë për bujqësinë, i cili nëpërmjet bankave të nivelit të dytë nuk ka ecur me atë pritshmëri që ne kemi pasur.

E dyta,...

Erion Braçe – Më vjen keq, por këtu janë disa zëra!

Arben Ahmetaj – Mos më ndërpre, të lutem!

Erion Braçe – Janë disa zëra. Kjo është tabela juaj, jo imja.

Arben Ahmetaj – Dakord.

Mos më ndërpre, nëse mundesh!

Po i referohem kryesisht. Mirëmbajtja e transportit rrugor nuk është prekur fare. Zero.

Të dyja llogaritë janë njëra tek investimet me vlerë 1,8 miliardë me fondet e BB-së dhe tjetra te mirëmbajtja sipër, me vlerë 1,6 miliardë nuk janë prekur, përkundrazi, janë konsoliduar.

Pra, këto janë rialokime në funksion të referencës që ministrat i bëjnë punës së tyre.

Erion Braçe – Po, por te transporti rrugor janë prekur 503 milionë. Pse është prekur ky fond?

Arben Ahmetaj – Nuk arrijnë dot të harxhohen deri në fund të vitit. Kjo nuk ka lidhje me mirëmbajtjen. Llogaria e mirëmbajtjes është me financimin e llogarisë totale të investimeve (kryesisht të huaja), që nuk e kap. Ka arsye. Po ta shihni, investimet e brendshme kanë ecur shumë më shpejt sesa investimet e huaja. Investimet e huaja kanë problematikën e tyre projekt pas projekti, por mirëmbajtja nuk është prekur.

Janë 2 llogari: njëra tek investimet me vlerë 1,8 miliardë lekë me fondet e BB-së dhe tjetra te mirëmbajtja me vlerë 1,6 miliardë lekë (në total 3,4 miliardë lekë), që nuk janë prekur.

Për herë të parë, janë mirëmbajtur.

Erion Braçe – Dakord, jam shumë i qartë.

Arben Ahmetaj – Shuma prej 4,6 miliardë lekësh që juve iu referuat, janë nga performanca e mbledhjes së të ardhurave te sigurimet shoqërore.

Pyetja tjetër që ju referuat me ...

Erion Braçe – Po këto të performancës ku shkojnë?

Arben Ahmetaj – Unë e thashë se po t'u referoheni, këto janë patjetër në funksion të konsolidimit fiskal, por mbi të gjitha, të bonusit për të kapur nivelin e 50 mijë lekëve të vjetra për pensionistët në fund të vitit, për të mos e quajtur atë “kokoshi një thelë” siç thuhet, se buxhet është ai. Bëj një llogari fare të shkurtër 3,3 miliardë lekë që janë afërsisht ose 33 milionë dollarë, plus 16 milionë dollarë që bëmë indeksimin në muajin maj, u shtua llogaria e pensionistëve me 50 milionë dollarë në vit.

Nëse i referohemi, sepse nuk duhet ta harrojmë totalin e pensioneve që shkon 1,2 minus statuset, i bie që çdo vit llogaria e pensionistëve të rritet me 5%. Sigurisht, nuk është shumë, por e mund inflacionin. Llogaria totale në fund të vitit do të jetë mesatarisht 2%.

Ju referuat me të drejtë se asnjë nuk është sovran në buxhetin e shtetit dhe besoj se ju e dini mirë, sepse keni një jetë që jeni në Komisionin e Ekonomisë. Përkundrazi, të gjithë

janë të varur nga buxheti i shtetit, që është pronë e Kuvendit të Shqipërisë. Nuk ka sovranitet brenda kësaj. Sovran është vetëm parlamenti.

Në aspektin e performancës në dijeninë time, KLSH-së i është rritur. Në dijeninë time ka pasur një investim me fonde të huaja, që është reduktuar, apo jo?

Për sa i përket vetingut, i nderuar kryetar, po ju them juve dhe qytetarëve (se fillon të bëhet mit pasi të dalë nga goja jonë), se në 6 muajt e parë të vitit 2018, e para një herë që komisionet dhe të gjitha zyrat e administrimit bujqësor janë të mirëfinancuara më mirë dhe me herë më shumë se në çdo periudhë tjetër të historisë së vetë. Në 6-mujor kanë harxhuar vetëm 20% të planit; në 7-mujor 27% të planit.

Erion Braçe – Të kujt plani?

Arben Ahmetaj – Të planit të buxhetit, pra.

Erion Braçe – Rroga, shpenzime operative, çfarë?

Arben Ahmetaj – Ja, po i ndaj tani të gjitha. Vetëm brenda rrogave, 34% të pagave.

Ju mendoni se unë do të lejoj që balanca të shkojë në njërin anë për arsye se dikush nuk ka performancë apo të shkojë në anën tjetër sepse dikush ka performancë? Më thoni në qoftë se një nga këta ngelet pa pagë dhe pa bonus.

Erion Braçe – Po, do t’jua them.

Arben Ahmetaj – Asnjë nuk ngelet.

Erion Braçe – Po patjetër, patjetër.

Arben Ahmetaj – Ja ku janë faktet. Faktet janë kokëforte, zyrtare. Pastaj nëse do të bëjmë mitizim, bëjmë sa të duash.

Erion Braçe – Jo, nuk po bëj mitizim.

Arben Ahmetaj – Ato janë institucione të mirëfinancuara dhe janë të detyruara t’i nënshtrohen performancës buxhetore. Kanë punën e tyre të nderuar dhe të mbështetur pa fund në veting. Vetingu është gjëja më e rëndësishme në atë sektor dhe jo vetëm në atë sektor. Financimi i tyre është i plotë. Asnjë nuk i shpëton dot performancës. Sigurisht, 20% në 6 muajt. Unë nuk mund t’i lë lekët të flenë, ndërkohë që ka projekte dhe institucione të tjera. Unë këtë detyrë kam.

Erion Braçe – Po, po.

Arben Ahmetaj – Ju iu referuat pagës mesatare. Po i referohem pagës mesatare në shtet, për shkak të rritjes së konsiderueshme që i kemi bërë. Paga mesatare ka njohur rritje reale me 3% në fund të vitit 2017. Besoj se shumë shpejt do të kemi edhe shifra të reja.

Për shkak të përmirësimit të kushteve të punës, sigurisht që do të kemi rritje të pagës reale. Sapo të dalin shifrat, do t’i ndajmë me ju.

Ndërkohë, po t'i referohemi Bankës Botërore, Shqipëria është me rritjen më të madhe të pagave që prej vitit 2010. Do t'ju tregoj edhe faqen. Është raporti i fundit i Bankës Botërore. Do t'ju dërgoj me *e-mail* gjithë këtë pjesë, për të parë ritmin e rritjes. Ndërkohë, mund t'ju jap edhe një informacion ende operativ, sepse jemi duke e detajuar.

E mbani mend kur kemi diskutuar përpara gati 8 muajsh që 42% e të punësuarve të VIP-at janë nën 30 mijë lekë pagë, që nuk është reale? Tani ka filluar (dhe do t'ju prezantoj trajektoren) të ngjitet lart në nivel, pra të ketë një formalizim më të madh të pagat. Unë besoj se kjo është një kauzë e drejtë për ta diskutuar në vazhdimësi pagën mesatare, pra jo se kemi zgjidhur punësimin. Nuk e kemi zgjidhur, por janë krijuar vende të konsiderueshme pune. Tani duam të kalojmë në nivelin më të lartë të zinxhirit, të një pagë më të lartë për qytetarin, në mënyrë që pastaj të kemi zinxhir konsumin, sektorët e tjerë, për të kapur atë që duam të kapim: rritjen e ndjeshme të mirëqenies.

Unë mund të thosha edhe këtë, se në një mënyrë apo në një tjetër ju iu referuat zhvillimit të disekuilibruar ekonomik. Patjetër që...

Erion Braçe – “Të pabarabartë” - thashë.

Arben Ahmetaj – Po, të pabarabartë.

Po të flasim me sy dhe me veshë jemi të ndjeshëm, por po të flasim me shifra, duhet të bëjmë një balancë midis...

Erion Braçe – Më fal! Unë shifra kërkoja, por ju më thatë se do të ma dërgonit me *e-mail* raportin e Bankës Botërore.

Arben Ahmetaj – Unë të dhashë shumë shifra, por ndoshta nuk i mbajta shënim.

Ti pret të të them atë që ke në mendje, por unë do të të them ato që janë në letër.

Erion Braçe – Problemi është që këtu drejtohem me “ju”, nuk drejtohem me “ti”.

Arben Ahmetaj – Një sekondë! Në rregull. Dakord.

Koeficientit *gini*, në qoftë se doni t'i referoheni shkencërisht, i referohemi për uljen e pabarazisë...

Erion Braçe – Varet. Shkencërisht, por varet.

Arben Ahmetaj – Koeficienti *gini* është përmirësuar, por, sigurisht, ta thuash këtë është e pamjaftueshme. Përfitimi i njëtrajtshëm ekonomik është sfidë në të gjitha ekonomitë, në ekonomitë e zhvilluara si në Gjermani, në Amerikë, në Itali, e jo më këtu. Patjetër që e kemi sfidë. Po t'i referohem asaj që ju thatë për lejet e ndërtimit, do t'ju thosha se lejet e ndërtimit janë një instrument ligjor në duart e pushtetit vendor...

Erion Braçe – Kjo nuk më shqetëson fare.

Arben Ahmetaj – Më falni! Çfarë ju shqetësonte?

Erion Braçe – Përqendrimi i parësë së lirë vetëm në një sektor dhe përqendrimi më pas i këtij sektori vetëm në një qytet.

Arben Ahmetaj – Kjo është një sfidë ekonomike. Patjetër që...

Erion Braçe – Është sfidë ekonomike.

Arben Ahmetaj – ..unë i pres me modesti, por besoj se edhe qeveria, kontributet e secilit nga ne, edhe të atyre që mungojnë, se si të prodhojmë instrumente për ta shpërndarë më mirë zhvillimin, kjo nuk diskutohet, por këto janë instrumente të ekonomisë së tregut. Sipërmarrja ka interes të investojë aty për 1 milion arsye dhe nuk besoj se do t'u hyjmë arsyeve një nga një se pse investohet më shumë në kryeqytet apo pse investohet pak më shumë në Durrës dhe jo kaq shumë në Gjirokastrë. Janë shumë faktorë të tregut, si: kërkesa, oferta e të gjitha llojeve të shërbimeve dhe produkteve, por hajdeni ta përmirësojmë. Pra, në qoftë se keni instrumente për t'i propozuar, nuk do të ishte keq t'i kthenim në ligje dhe në procedura.

Sa i takon turizmit, zoti kryetar, meqenëse iu referuat, nëse shiten apo janë si struktura akomoduese, ka një sërë investimesh në sektorin e turizmit, si dhe një sërë kërkesash, por nuk po u referohem kërkesave. Patjetër që numri i shtretërve vjen në rritje, por duke iu referuar ligjit për turizmin të vitit 2015 ne kemi afruar një model, i cili shkon paralelisht me të dyja, duke iu referuar edhe rajonit.

Në Kroaci, kombinimi i rezidencave për timeshare-n merr hotelet me yje dhe është në funksion të përmirësimit të kthimit të investimit dhe besoj se është një standard normal gjithandej. Unë jam dakord që zhvillimi i turizmit nuk mund të jetë me vila rezidenciale, duhet të jetë me struktura akomoduese, por në këndvështrimin tim dhe në njohuritë e mia statistikore ka një raport të shëndetshëm midis ndërtimit të rezidencave për timeshare-n dhe hoteleve. Nuk e di nëse lashë ndonjë nga pyetjet tuaja pa ju përgjigjur, por nuk e besoj.

Pra, këto ishin përgjigjet e mia për pyetjet tuaja.

Erion Braçe – A ka pyetje të tjera?

Ervin Bushati – Para dy vjetësh na është paraqitur, edhe kur kemi bërë programin bashkë, edhe kur kemi qenë në opozitë, pjesa e lehtësimit të funksionimit të sektorit të turizmit. Pra, ne mendojmë se kemi bërë maksimumin, kemi ulur TVSH-në, si dhe lehtësira të tjera. Do të duhej të kishim të njëjtin reagim edhe nga industria e turizmit siç na është thënë shpesh se do të normalizohemi dhe do të dalë gjithçka, pasi kjo nuk ka të bëjë me formalizimin dhe se sa mbledh shteti, por ka të bëjë me garancinë, standardizimin, kushte më të pastra, jetë më të sigurt, turistë që rikthehen, dhe po shihet edhe një rritje e sektorit dhe një pronotim shumë i madh si në sitet ndërkombëtare në *Booking B&B*, ku të gjitha çmimet

janë reale, sepse bëhen nga të gjitha hotelet, edhe nga ata që i japin me qira, si edhe ato që ju thatë për timeshare-n, kurse ato që prezantohen në shtet janë të tjera.

Pra, mendoj se duhet parë një mënyrë për ta ndjekur realitetin edhe në mënyrë elektronike se sa janë çmimet në *Booking.com* dhe sa ia paraqesin shtetit kur paguajnë taksat e të tjera. Ky ishte pak a shumë një lloj sugjerimi.

Faleminderit!

Erion Braçe – Po, zoti Ahmetaj.

Arben Ahmetaj – Zoti kryetar, dua t’ju bëj me dije se përpara 4 muajsh kam nisur bisedimet me *Booking.com* dhe RB&B për të hyrë në një marrëveshje të detajuar ku **RB&B** dhe *bukning.com* të jenë të detyruara të raportojnë në autoritetin fiskal shqiptar të gjitha rezervimet dhe konsumimin e rezervimeve të të gjithë shtetasve shqiptarë në Shqipëri, dhe të gjitha pronave shqiptare që jepen me qira. Kjo do të bëjë të mundur një formalizim më të madh. Këtë kemi një formalizim të konsiderueshëm në turizëm, por vitin tjetër me marrëveshjen e finalizuar me RB&B dhe *bukning.com*, që besoj deri në janar do ta kemi finalizuar do të kemi mundësi që çdo pronë që jepet me qira nëpërmjet këtyre portaleve e sistemeve ta kemi në pasqyrën e tatimeve për t’u taksuar në nivel real në referencë të çmimit real. Unë mund t’ju jap komunikimin që kam me RB&B dhe *bukning.com* që ta keni pjesë të dosjes suaj të informacion për atë që unë them.

Erion Braçe - A ka pyetje të tjera?

Antoneta Dhima- Në lidhje me aktin normativ ju thatë që do të bëhen rialokime brenda zërave të shpenzimeve, konkretisht “rialokim të shpenzimeve kapitale”, nga projekte me ecuri të ngadaltë në projekte që kanë ecuri më të shpejtë. A mendoni ju që këto rialokime do të sjellin realizim të projekteve deri në fund të vitit?

Duke pasur parasysh realizimin faktik se pak a shumë ju e keni përfunduar evidencën e realizimit të të ardhurave të 8 mujorit, a mendoni që deri në fund të vitit ju do të realizoni planin e të ardhurave sipas parashikimit në fillim të vitit?

Arben Ahmetaj- Sa i përket pyetjes së parë, po.

Sa i përket pyetjes tjetër, patjetër që planifikimi i të ardhurave është një element, ndërsa realizimi i tyre është një element tjetër dhe për 1000 shkaqe ecja, administrata apo elemente ekzogjen, siç ju referova edhe kursit të këmbimit që patjetër godasin performancën e të ardhurave, besoj se e rëndësishme është që deficitin, primarin dhe borxhin do të jenë të gjitha në bazë të parametrave që ne kemi rënë dakord. Do t’ju bëj edhe krahasimin se si kanë shkuar planet dhe faktet në 10 vjetët e fundit, nga 250 dhe 300 milionë dollarë që ka pasur çdo vit në atë qeveri, në qeverinë e PD-së, dhe si ka ecur në mandatin e parë dhe po ecën në

këtë mandat tonin planifikimi dhe realizimi. Sot ne mbledhim 27,7 % të GDP-së ndërkohë që dikur mblidhej 23-24%. Nuk është mjaft, por duhet të arrijmë 30 e 32%, nëpërmjet formalizimit të zhvillimit ekonomik. Askush nuk e ndërton shtëpinë për një ditë.

Arben Pëllumbi – Zoti Ministër, do të doja të dija një opinion tuajin, por më shumë në terma ekonomikë jo racionalë, sepse nuk është detyra juaj dhe as e këtij komisioni që të diskutojë për këtë çështje, e cila ka të bëjë me shkakun e radhës së mungesës së opozitës sot në punimet e komisionit dhe mbase edhe në marrëdhëniet e kushtëzuara me Kuvendin, që është siguria në vend.

Në terma ekonomikë ne kemi kaluar një sezon turistik që e konsiderojmë relativisht të suksesshëm. A keni pasur rënie të pritshmërive, a keni pasur anulim të kontratave si rezultat i kësaj situate sigurie që ka pasur vendi?

Arben Ahmetaj- Unë do t'ju them me bindje që numrat në përmirësim të turizmit me mbi 12 % janë një fakt i fortë e i gjallë i përmirësimit të imazhit të vendit dhe i përmirësimit të perceptimit të sigurisë në vend.

E dyta, ministri i Brendshëm dje ka bërë një rezymë të ndjeshme dhe statistikore dhe vetëm fakti se rënia e vrasjeve me nga dy herë që nga koha e qeverisjes së PD-së, madje ai edhe kur ka qenë ministër i Brendshëm ka vrarë njerëz vetë, kështu që nuk numërohet se duhej ta kishte kapur dekriminalizimi, tregon se përmirësimi i sigurisë në vend në statistikë është i ndjeshëm. Ajo që bën opozita është vetëm për të hedhur baltë dhe për të krijuar perceptimin se situata e sigurisë në vend është e keqe.

Unë besoj, edhe duke iu referuar atyre që ka thënë ministri i Brendshëm me detaje, se në vend ka siguri. Më thoni një turist që ka pësuar një problem! Shyqyr Zotit, po e them me zhargon, që nuk ka pasur asnjë incident! Këtë vit numri i turistëve do të shkojë në 5,5 milionë. 4,4 milionë turistë të huaj e kanë vizituar vendin dhe kanë ikur me idenë se ky është një nga vendet më normale në Europë për sa i përket qetësisë dhe sigurisë.

Erion Braçe – A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

A ka diskutime? Nuk ka.

Për ta mbyllur, dua të them unë disa fjalë.

Së pari, ky komision ka qenë gjithmonë i hapur për të mirëpritur jo vetëm opinionin e qeverisë, e cila pa asnjë lloj diskutimi që ka detyrim kushtetues për t'iu përgjigjur këtij komisioni, por, mbi të gjitha, për t'i krijuar mundësinë për të folur, për të dhënë opinionin dhe mendimin e saj, natyrisht edhe për t'u ballafaquar, opozitës.

Të dhënat e diskutimeve në këtë komision janë fare të qarta. Pavarësisht dëshirës së opozitës për t'u treguar anormale në këtë komision, ne kemi pasur të gjithë vullnetin për të

krijuar mundësinë që gjithçka, që thotë nga foltorja e selisë, të vijë në këtë komision e ta ballafaqojë. Ikja nga ky ballafaqim, dëshmon edhe një herë se gjithçka që bëhet nga ajo foltore është thjesht për nevojat e propagandës së ditës dhe pa asnjë lloj interesi që lidhet drejtpërdrejt me interesat e qytetarëve apo edhe me interesin publik. Ndryshe, ato që konsiderohen fakte në atë foltore, duhej të ishin sot këtu për t'u ballafaquar një më një me të dhënat zyrtare jo të ministrisë, por të thesarit të shtetit, që është një instrument tërësisht i pandikuar nga politika. Duke shprehur keqardhjen, po e mbyll këtu me faktin që është zgjedhje e tyre të jenë, ashtu siç është zgjedhja jonë të vijojmë më tutje.

Së dyti, pa asnjë lloj diskutimi, është mënyra e menaxhimit të buxhetit të shtetit jo vetëm për vitin 2018, por edhe një vit më herët, të cilin ne do ta shqyrtojmë me projektligjin për buxhetin faktit që do të diskutohet. Përsëri në këtë komision ka vend për t'u vlerësuar pozitivisht qoftë në parametrat e rritur të menaxhimit të të ardhurave publike, qoftë edhe në parametrat efektivë të menaxhimit të shpenzimeve buxhetore, pa asnjë lloj diskutimi edhe në realizmin e objektivave që ne kemi vendosur, të cilat kjo qeveri, kjo maxhorancë, ia ka vendosur vetes në të gjitha aspektet, qoftë në mbledhjen e të ardhurave, qoftë në menaxhimin e shpenzimeve, mbi të gjitha, të menaxhimit të borxhit publik, një trashëgimi, të them të drejtën, e rëndë, e marrë nga partia që sot mungon këtu, por, brenda së gjithësh, pa asnjë lloj diskutimi ka nevojë edhe për përmirësime. Unë vazhdoj të insistoj për ato pika, për të cilat pyeta dhe mora ato përgjigje. Pa asnjë lloj diskutimi secila nga ministrinë e linjës, që merret drejtpërdrejt me menaxhimin e buxheteve qoftë të shpenzimeve operative të mirëmbajtjes, qoftë edhe të shpenzimeve për investime publike ka nevojë të shkundet për të realizuar në kohë dhe sipas ritmikës së përcaktuar nga ministria përgjegjëse për menaxhimin e buxhetit, Ministria e Financave dhe shpenzimet e saj, nevoja për më shumë shpenzime në kushte kur kemi një suficit buxhetor, ashtu siç thatë edhe ju zoti Ministër, madje edhe më të madh se të një viti më parë, kur për shkak të marrëveshjes ishim të detyruar të mos kishim as shpenzime, as prokurime nga prilli deri kur vendosëm që të mbyllim zgjedhjet e viti që shkoi e të tjera me radhë. Natyrisht që ky është një tregues që duhet t'i vërë në lëvizje të gjitha ministrinë, të gjitha drejtorinë dhe të gjitha entet prokuruese, me qëllim që t'u përgjigjen në kohë shpenzimeve të buxhetit të shtetit dhe këto shpenzime të mos shfazohen për t'u përqendruar në muajt nëntor dhe dhjetor, që është edhe shqetësimi juaj permanent i paraqitur para këtij komisioni, por edhe para institucioneve të tjera kushtetuese, të cilat auditojnë shpenzimet publike të buxhetit të shtetit. Kështu që nuk ju takon juve, por pa asnjë lloj diskutimi edhe ju jeni pjesë e kësaj, për të nxitur dhe për të çuar edhe më tutje punën e këtyre institucioneve dhe enteve prokuruese, ku një pjesë e tyre varen edhe nga Kuvendi. Edhe ne do të bëjmë

punën tonë kundrejt atyre institucioneve, që më lejoni t'ju them se janë tmerrësisht të ngadalta, jo për arsye administrative, por për arsye të tjera, me të cilat në muajt në vijim do të ketë ballafaqim, por edhe me ministritë e linjës, në mënyrë që të çojmë para ato projekte, të cilat janë buxhetuar që në dhjetor të vitit të kaluar dhe që normalisht duhet të ishin efektive për qytetarët e Republikës së Shqipërisë në territoret respektive përkatëse.

Së treti, dua të vë theksin në ato problematika që ngrita. Zoti Ministër, pa asnjë lloj diskutimi që pabarazia është një element shumë i rëndësishëm, është po aq i rëndësishëm sa kërkon kohën e vet për t'u adresuar. Natyrisht, unë mendoj se kjo maxhorancë ka bërë hapa të konsiderueshëm pikërisht për të goditur këtë fenomen, pabarazinë, por në krahun tjetër, pa asnjë lloj diskutimi, në këtë rrugë që kemi nisur duhet t'i çojmë gjërat deri në fund, unë vazhdoj të insisto, qoftë për pagën minimale, qoftë për pagën mesatare. Më lejoni t'ju ilustroj: kam marrë shifra nga ju, të xhiros vjetore dhe, natyrisht, të fitimit të deklaruar gjatë vitit që shkoi, është e paimagjinueshme që një deputet i Kuvendit të Shqipërisë të deklarojë fitim si aksioner dhe si pronar 10 milionë dollarë në vit, ndërkohë që ne sot diskutojmë 5-mijëlekëshin e pensionistëve. Dizbalanca është shumë e madhe. Pavarësisht se do të tatohet vetëm 15%, po ju them se është e pamjaftueshme ajo normë tatimore që ne kemi vendosur për këto norma fitimi, të cilat, në rast se janë të vërteta, më lejoni t'ju them se janë të turpshme. Pikërisht për këtë arsye jo vetëm te punësimi i madh, që, për hir të së vërtetës, shifrat flasin vetë 690 mijë të punësuar ndodhen në borderotë e shtetit, kur kemi pasur një trashëgimi me 420-430 apo 440 mijë punëtorë, natyrisht që janë edhe domethënëse. Por duhet të shkojmë edhe më tutje, pikërisht tek të ardhurat që përfitojnë këta punëtorë. Më lejoni t'ju them se te këta 690 mijë nuk janë punëtorët e bujqësisë, ku produktiviteti është tejet i ulët dhe ku të ardhurat që përfitohen në pjesën dërrmuese të territorit që merren në bujqësi, janë thuajse të ardhura për kushte mbijetese. Ky është shqetësimi im, i cili lidhet me atë që ju thashë dhe për të cilën ju pyeta edhe më sipër. Natyrisht, ka instrumente që mund t'i frenojnë zhvillimet e pakontrolluara që mund të rikthejnë ciklin e flluskave në këtë vend. Përqendrimi i gjithë parasë së lirë thjesht dhe vetëm në sektorin e ndërtimit apo përqendrimi thjesht dhe vetëm në një rajon, natyrisht që krijon boshllëqe të paimagjinueshme në zhvillimin e pjesëve të tjera të territorit të vendit dhe të sektorëve të rëndësishëm që kanë edhe një segment të gjerë punësimi, siç është bujqësia.

Kështu, më lejoni t'ju them se pa asnjë diskutim do të duhet që edhe institucionet e qeverisjes vendore, të cilat kanë marrë të gjithë sovranitetin për të menaxhuar resurse të ndryshme, por edhe leje, shërbime, licenca etj., duhet të orientohen që të kenë një përmasë

zhvillimi, e cila nuk do të kthehet nesër në një flluskë, që dëmton të gjithë ekonominë kombëtare.

E njëjta gjë vlen edhe për turizmin. Pyetja që bëra shfaq një shqetësim real për mua, ndërsa për ju varet si e gjykoni, por po të shohësh zhvillimin skandaloz (për mua) të strukturave për shitje në Gjirin e Lalzit, është dhimbje. Si mundet që një pasuri aq e madhe natyrore, me një potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin e turizmit atje, pothuajse për 10-12 muaj të vitit do të jetë bosh për shkak të atij zhvillimi skandaloz, duke urryer edhe pishat dhe në lëvdime të tullave e të llaçit dhe të betonit që po instalohet atje.

Ky ishte shqetësimi që kisha për këtë sektor dhe për trendin e zhvillimeve të ndërtimit, të strukturave akomoduese pikërisht në ato territore, duke filluar nga Lalzi dhe duke vijuar po të doni, edhe sipër, edhe poshtë.

Së fundi, akti normativ ka brenda tij një element shumë pozitiv, pagesën e solidaritetit për ato shtresa që janë vërtet shtresat më vulnerabël të shoqërisë sot, pensionistët dhe familjet që janë sot me ndihmë ekonomike, pagesa invaliditeti, status invaliditeti dhe kategori të tjera të këtij lloji. Pikërisht, kjo është një arsye pse pa diskutim po pranohet edhe fakti i kryer, që është akti normativ, sepse praktikisht po diskutojmë mbi një fakt të kryer.

Thënë këtë, kam 2 gjëra për këtë fakt të kryer:

Së pari, po ndalem te institucionet e pavarura kushtetuese. Pa asnjë diskutim që sovraniteti nga pikëpamja buxhetore i KLSH-së apo i institucioneve të tjera të këtij lloji, kufizohet nga parlamenti, por vetëm nga parlamenti, zoti Ministër, jo nga qeveria. Ky është problemi që kemi me ato institucione. Ky është problemi i atyre institucioneve në raport me institucionet që i monitorojnë ato, që janë institucionet ndërkombëtare.

Së dyti, duke vlerësuar pozitivisht të gjithë paketën e solidaritetit, e cila që nga viti 2014 e në vazhdim është shumëfishuar në përgjigje të shtresave në nevojë (ma kujtuat ju, se nuk doja ta përmendja), por në program kemi premtuar 7 mijë-10 mijë lekë në vit për çdo individ.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të isha shumë i lumtur dhe pa asnjë diskutim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, unë gjithmonë më pak se ju, që keni buxhetin e shtetit në dorë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rast se do të vijmë këtu, zoti Ministër, do të vijmë këtu. Pa asnjë diskutim do të keni vlerësime edhe më të mëdha sesa këto që morët sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur t'i meritoni, zoti Ministër, jo kur nuk i meritoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

As ju, asnjë njeri tjetër nuk mund t'i marrë, kur nuk i meritoni.

Ka ndonjë gjë tjetër? Nuk ka.

Kalojmë në votimin e aktit normativ!

Bëhet vetëm një votim për aktin normativ, ose votohet pro ose votohet kundër.

Kush është kundër? Nuk ka.

Kush është pro?

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet akti normativ.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA